



WIZZ AIR HUNGARY LTD.
KUSHTET E PËRGJITHSHME TË TRANSPORTIT TË PASAGJERËVE DHE TË
BAGAZHEVE

Në fuqi nga 1 korriku 2020

Pasqyra e lëndës

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI.....	2
2. ZBATUESHMËRIA.....	7
3. TARIFAT DHE SHËRBIMET SHITESË.....	7
4. ORARI	8
5. KONTRATA PËR TRANSPORTIN AJROR	8
6. REZERVIMI DHE NDEJËSET.....	8
7. TARIFA TOTALE E FLUTURIMIT, TAKSAT, PAGESAT DHE TARIFAT PËR SHËRBIMET E TJERA	11
8. MBROJTJA E TË DHËNAVE.....	13
9. CHECKIN-i DHE IMBARKIMI.....	13
10. ZHDOGANIMI DHE KONTROLLI I SIGURISË	16
11. DOKUMENTET E UDHËTIMIT	16
12. REFUZIMI I TRANSPORTIT	16
13. RREGULLAT SPECIALE QË APLIKOHEN PËR TRANSPORTIN AJROR TË PASAGJERËVE.....	17
14. BAGAZHI.....	19
15. NDRYSHIMI I KONTRATËS NGA WIZZ AIR	22
16. RIMBURSIMI DHE E DREJTA PËR PËRKUJDESJE.....	24
17. PËRGJEGJËSIA.....	24
18. NJOFTIMI NË KOHË PËR ANKESAT, KUFIZIMI KOHOR PËR PADITË	27
19. RREGULLORJA CHARTER	28
20. ZGJIDHJA ALTERNATIVE E MOSMARRËVESHJEVE.....	29
21. ZGJEDHJA E LIGJIT DHE JURIDIKSIONI	29

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1. Përkufizimet dhe rregullat e interpretimit në këtë Nen zbatohen në këto Kushte të përgjithshme të transportit:

SHËRBIMET SHITESË nënkupton çdo produkt dhe shërbim të blerë prej jush në lidhje me transportin ajror dhe që sigurohet, ofrohet ose shitet nga ofrues palë të treta, për shembull makinë me qira, akomodim në hotel. Në raste të caktuara Shërbimet shtesë mund të përbëjnë një Paketë.

TARIFA E ADMINISTRIMIT TË PËRCAKTUAR: tarifa e pagueshme për pasagjer për fluturim nëse caktoni pretendimin tuaj, siç përcaktohet në nenin 14.7.8 dhe 17.4.9 dhe në shumën e specifikuar në Uebsajt në momentin e lidhjes së Kontratës.

VENDI I NDALIMIT I RËNË DAKORD: një vend zbritjeje i treguar si i tillë në Itinerar dhe në databazën tonë, që nuk konsiderohet Vend nisjeje ose Vend destinacioni.

BAGAZH: nënkupton pronën tuaj që nuk përjashtohet nga transporti, e cila ju shoqëron juve në udhëtimin tuaj si Bagazh i regjistruar, Bagazh i paregjistruar ose Pronë personale.

ETIKETA IDENTIFIKUESE E BAGAZHIT: një dokument që lëshohet vetëm për identifikimin e Bagazhit tuaj të regjistruar dhe që vendoset në Bagazhin tuaj të regjistruar.

ETIKETA KËRKUESE E BAGAZHIT: një dokument që lëshohet vetëm për identifikimin e Bagazhit tuaj të regjistruar, që i ngjitet Kartës suaj të imbarkimit.

KARTA E IMBARKIMIT: një dokument (i) i lëshuar në sportelin e checkin-it kundrejt kodit tuaj të rezervimit ose itinerarit tuaj dhe Dokumenteve të vlefshme të udhëtimit; ose (ii) i printuar ose i shkarkuar prej jush ose i afishuar në pajisjen tuaj celulare nëse përdorni aplikacionin për celular të Wizz Air (Passbook ose aplikacion tjetër me funksion të ngjashëm) pas plotësimit të procedurës së checkin-it në internet ose në celular, që ju lejon të hipni në bordin e avionit.

CALL CENTER: shërbimi për klientët që jepet përmes telefonit, numrat aktualë të telefonit të cilët mund të gjenden në Uebsajt.

TARIFA E ANULIMIT: tarifa e pagueshme prej jush nëse anuloni një rezervim, siç përcaktohet në nenin 6.5.1 dhe në shumën e përcaktuar në faqen e internetit në momentin e lidhjes së kontratës.

MARRËVESHJE CHARTER: një kontratë për transport charter e lidhur në përputhje me këto Kushte të përgjithshme transporti.

BAGAZHET E REGJISTRUARA: Bagazhet tuaja që ne i marrim në dorëzim për qëllim transportimi, dhe për të cilat kemi lëshuar një Etiketë identifikimi Bagazhi dhe një Etiketë kërkuese Bagazhi në momentin e marrjes në dorëzim.

AFATI PËRFUNDIMTAR I CHECKIN-IT: kufiri kohor i specifikuar në këto Kushte të përgjithshme të transportit deri në të cilin duhet të keni përfunduar formalitetet e checkin-it dhe të keni marrë Kartën e imbarkimit.

KODI CIVIL: Ligji hungarez V. i vitit 2013 në Kodin Civil

KODI I PROCEDURËS CIVILE: Ligji hungarez CXXX. i vitit 2016 në Kodin e Procedurës Civile

KUSHTET E KONTRATËS: kushtet që përmban Itinerari juaj, këto kushte të përgjithshme të transportit dhe politika e privatësisë

FLUTURIMET TRANZIT: dy ose më shumë segmente fluturimi Wizz Air për çdo drejtim të rezervuar në të njëjtin rezervim.

KONTRATA (PËR TRANSPORTIN AJROR): kontrata për transportin ajror të Pasagjerëve dhe të Bagazheve, e lidhur mes jush dhe Wizz Air në përputhje me Kushtet e kontratës, në bazë të së cilës ne ju transportojmë juve dhe Bagazhin tuaj nga Vendi i nisjes në Vendin e destinacionit. Kontrata përbëhet nga Itinerari dhe Etiketë identifikuese e Bagazhit.

KONVENTA: “Konventa e Montrealit për unifikimin e rregullave të caktuara në lidhje me transportin ajror”, e nënshkruar në Montreal në 28 maj 1999, me ndryshimet dhe shtesat përkatëse.

VENDET E PREKURA NGA TRANSPORTI: ato vende në të cilat ndodhet Vendi i nisjes, Vendi i destinacionit dhe Vendi i ndalimit i rënë dakord.

EKUIPAZHI: personeli i autorizuar që kryen detyrat në bordin e avionit, të tillë si pilotët, stjuardesat, personeli teknik dhe i sigurisë.

DITË: ditët kalendarike, duke përfshirë të shtatë ditët e javës, me kusht që për qëllime njoftimi, dita në të cilën jepet njoftimi nuk do të numërohet në afatin përfundimtar.

ZEE: Zona Ekonomike Evropiane, duke përfshirë shtetet e veta anëtare.

BE: Bashkimi Evropian, duke përfshirë shtetet e veta anëtare.

BAGAZH EKSTRA NË BORD (ÇANTË ME RROTA): Bagazhi juaj veç bagazheve të regjistruara dhe të dorës në përputhje me këto kushte të përgjithshme të transportit, me faturat përkatëse të shërbimit, që merret në bord për të gjithë kohëzgjatjen e udhëtimit.

RRETHANA TË JASHTËZAKONSHME: shkaqe dhe/ose rrethana jashtë kontrollit të arsyeshëm të Wizz Air të cilat nuk mund të shmangeshin edhe nëse do të ishin marrë të gjitha masat, të tilla, por pa u kufizuar me, forcat madhore, paqëndrueshmëria politike, kushtet meteorologjike të papërputhshme me funksionimin e fluturimit në fjalë, rreziqet e sigurisë, grevat, mangësitë e papritura në sigurinë e fluturimit dhe vendimet e menaxhimit të trafikut ajror të cilat, në lidhje me një avion të veçantë në një ditë të veçantë, krijojnë një vonesë të gjatë ose anulim të një ose më shumë fluturimeve nga ai avion.

TARIFA E FLUTURIMIT: çmimi i transportit ajror nga Vendi i nisjes deri në Vendin e destinacionit. Tarifa e fluturimit përfshin taksat dhe tarifat (duke përfshirë taksat aeroportuale dhe taksat qeveritare) dhe shumën më të ulët të disponueshme të tarifave për shërbimet e tjera të pashmangshme për qëllimin e rezervimit.

TARIFAT PËR SHËRBIMET E TJERA/TARIFAT E SHËRBIMEVE: tarifat e pagueshme për shërbime të ndryshme në lidhje me transportin ajror, të përcaktuara në Uebsajt, përveç Tarifës për ruajtjen e ndenjës, Tarifës së anulimit, Tarifës së Wizz Discount Club dhe tarifës së pagueshme për Shërbimet shtesë.

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË TRANSPORTIT: dispozitat përkatëse për transportin ajror të të pasagjerëve dhe të bagazheve të kryer nga Wizz Air, siç përcaktohen në këto kushte të përgjithshme të transportit.

LIGJI RREGULLUES: ligjet e Hungarisë në fuqi në çdo kohë.

DEKRET QEVERITAR/DEKRET: “Dekreti i Qeverisë Hungareze 25/1999”. (II.12.) mbi rregullat e transportit ajror, me ndryshimet përkatëse.

BAGAZHI I DORËS (BAGAZHE CARRY-ON): Bagazhi juaj përveç bagazheve të regjistruara në përputhje me këto kushte të përgjithshme të transportit, të përfshira në tarifë, që mbetet në kujdesin tuaj për të gjithë kohëzgjatjen e udhëtimit.

IATA: International Air Transport Association.

FOSHNJË: një fëmijë i moshës nën dy vjeç, por që është jo më pak se dy javësh në datën e udhëtimit.

ITINERARI: (i) dokumenti i lëshuar për Pasagjerët pas pagesës së plotë të Tarifës totale të fluturimit të Wizz Air ose (ii) në rast ndryshimesh në rezervim nga Pasagjeri, dokumenti i lëshuar për Pasagjerin si pranim i këtyre ndryshimeve nga Wizz Air. Itinerari përmban emrin e pasagjerit dhe detajet e fluturimit të tilla si Vendi i nisjes, Vendi i destinacionit dhe Vendi i ndalimit i rënë dakord, nëse ka, orari i nisjes dhe i mbërritjes; dhe përcakton referencat për Kushtet e kontratës dhe informacione të tjera të rëndësishme. Nëse e bëni rezervimin tuaj përmes Call Center-it tonë, ju do të njoftoheni për kodin e rezervimit dhe Itinerari do t'ju dërgohet me faks, email ose postë, në përputhje me këto Kushte të përgjithshme transporti.

ETIKETA E LËSHIMIT TË KUFIZUAR: dokumenti që deklaron përgjegjësinë tonë të kufizuar për Bagazhin e regjistruar që në ndonjë mënyrë është dëmtuar ose nuk është në madhësinë apo kushtet e duhura, ose që përmban artikuj të brishtë të pranuar prej nesh për transport dhe që është lëshuar në kohën e marrjes në dorëzim të këtij Bagazhi. Etiketa regjistron mangësitë dhe karakteristikat e lartpërmendura.

TARIFA PËR HUMBJEN E FLUTURIMIT: është tarifa e pagueshme në raste të caktuara të përshkruara në nenin 9.16 nëse humbni fluturimin tuaj dhe dëshironi të transferoheni në një fluturim tjetër të operuar prej nesh. Shuma e tarifës përcaktohet në Uebsajt.

PAKETA/UDHËTIMI ME PAKETË: nënkupton paketën sipas nenit 2 § 6) të Dekretit të Udhëtimit me paketë, me përjashtim të nenit 13, raste në të cilat Wizz Air konsiderohet si organizator ose shitës i paketës. Në rast se kombinimi i Shërbimit shtesë të zgjedhur, përbën Paketë, Wizz Air ju njofton gjatë rezervimit.

DEKRETI I UDHËTIMIT ME PAKETË: Dekreti i Qeverisë Hungareze 472/2017. (XII.28) rreth rregullave të kontratave për shërbimet e udhëtimit dhe në veçanti kontratat për udhëtim me paketë dhe përgatitjet e udhëtimit të lidhur.

PASAGJERI, JU, JUAJ: personi i emërtuar si pasagjeri në itinerar, që është transportuar ose do të transportohet në avion me miratimin tonë.

PASAGJER ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË LËVIZJE OSE QË KËRKON ASISTENCË TË VEÇANTË: nënkupton çdo pasagjer me aftësi të kufizuara në lëvizje për shkak të paaftësisë fizike (ndijore ose lokomotore), dëmtimit intelektual, moshës, sëmundjes ose çdo shkak tjetër aftësie të kufizuar kur përdor transportin ose situata e të cilit ka nevojë për vëmendje të veçantë.

PRONA (PRONAT) PERSONALE: nënkupton artikujt e listuar në paragrafin 14.1.4 të këtyre kushteve të përgjithshme të transportit që mund të merrni në bord, përveç bagazheve të regjistruara, pa pagesë.

VENDI I NISJES: aeroporti i treguar në itinerar dhe në databazën tonë si pika e nisjes së transportit ajror.

VENDI I DESTINACIONIT: aeroporti i destinacionit i transportit ajror i treguar si i tillë në itinerar dhe në databazën tonë.

DEKLARATA E PRIVATËSISË: politika në Uebsajtin tonë që rregullon trajtimin e të dhënave personale që jepen prej jush ose Rezervuesit të Wizz Air.

RREGULLORJA 261: “Rregullorja (KE) Nr. 261/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit”, me ndryshimet ose shtesat përkatëse.

REZERVUESI është individ i moshës madhore dhe që ka zotësi të plotë ligjore ose një person juridik që vepron si agjent për pasagjerin dhe që kryen prenotimin në emrin e tij/saj dhe për llogari të tij/saj dhe/ose në emrat e pasagjerëve të tjerë dhe për llogari të tyre, si dhe që merr përsipër detyrimet e përcaktuara në klauzolat 6.1.4 - 6.1.7. Rezervuesi përfshin gjithashtu një individ ose shoqëri që na paguan neve Tarifën e plotë të fluturimit siç tregohet në Itinerarin e një Pasagjeri dhe agjencive të udhëtimit.

ORARI: orari i mbërritjes dhe i nisjes i fluturimeve individuale të përcaktuara nga Wizz Air dhe të publikuara në Uebsajt.

SDR: E drejta speciale për tërheqje, sipas përkufizimit nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. (Vlera aktuale e kësaj monedhe mund të gjendet në Uebsajtin e FMN-së - www.imf.org - dhe në faqet financiare të gazetave të mëdha.)

TARIFA PËR RUAJTJEN E NDENJËSES: tarifa e pagueshme prej jush në shumën e përcaktuar në faqen e internetit në momentin e lidhjes së kontratës nëse Wizz Air ushtron të drejtën e vet të anulohet rezervimin tuaj në përputhje me këto kushte të përgjithshme transporti, ose ju anuloni rezervimin siç përcaktohet në klauzolën 6.5.2.

OFRUESI I SHËRBIMIT: nënkupton ofruesin palë të tretë që ofron, siguron, zhvillon ose shet Shërbimet shtesë, duke përfshirë edhe nëse ofrohen të bashkëpunim ose në emër të një pale tjetër të tretë.

TARIFAT: rregullat dhe kushtet e disponueshme në Uebsajt në lidhje me Tarifën totale të fluturimit dhe kushtet, tarifat dhe pagesat për shërbime të ndryshme që ofrojmë ne, si dhe rregullore të tjera të Wizz Air. Informacione të mëtejshme rreth Tarifave tona mund të gjenden në Uebsajtin tonë në lidhjen <https://wizzair.com/en-gb/information-and-services/prices-discounts/all-services-fees/>.

TARIFA TOTALE E FLUTURIMIT: çmimi i pagueshëm për të gjitha shërbimet e ofruara për ju nga Wizz Air, i cili përfshin tarifën e fluturimit për transportin ajror dhe Tarifat për Shërbimet e tjera ose tarifat për çdo shërbim tjetër që ju blini në Uebsajt.

DOKUMENTET E UDHËTIMIT: dokumentet e kërkuara nga Vendet e prekura nga Transporti për kalimin e kufirit, kalimin tranzit dhe/ose qëndrimin në shtetin e caktuar.

BAGAZHE TË PAREGJISTRUARA: Bagazhet tuaja përveç bagazheve të regjistruara në përputhje me këto kushte të përgjithshme të transportit, që merren në bord gjatë gjithë kohëzgjatjes së udhëtimit.

UEBSAJTI: wizzair.com

NE, NEVE, TONË, Wizz Air: i referohet Wizz Air Hungary Ltd. dhe punonjësve, punëtorëve të shërbimit dhe agjentëve të vet.

- 1.2. Titujt e neneve jepen vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit.
- 1.3. Çdo frazë e prezantuar me termat “duke përfshirë”, “përfshin”, “në veçanti”, ose çdo shprehje e ngjashme do të interpretohet si ilustruese dhe nuk do të kufizojë kuptimin e fjalëve që paraprijnë ato terma.

2. ZBATUESHMËRIA

2.1. Dispozitat e Përgjithshme

- 2.1.1. Dispozitat e këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit janë pjesë e Kontratës në fuqi në datën e lëshimit të Itinerarit dhe i aplikohen Kontratës nëse Wizz Air tregohet në itinerarin tuaj si operatori i fluturimit.
- 2.1.2. Përveç dispozitave të këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit, zbatohen gjithashtu Kushtet e përgjithshme të Udhëtimit me paketë, nëse keni blerë Udhëtim me paketë nga ne.
- 2.1.3. Përveç këtyre Kushteve të përgjithshme të zbatueshme të transportit, çdo Ofrues shërbimi do të ketë kushtet e veta të përgjithshme të zbatueshme, të cilat rregullojnë produktet e tij. Edhe nëse Shërbimet shtesë të blera përbëjnë një Udhëtim me paketë, secili shërbim dhe produkt ka kushtet e veta të përgjithshme të zbatueshme, të cilat i drejtojnë ato. Sigurohuni që t'i keni lexuar të dyja këto kushte të përgjithshme të transportit, të gjitha informacionet dhe njoftimet përkatëse dhe kushtet për shërbimet e mundshme shtesë të ofruara nga ofruesi përkatës i shërbimeve, përpara se të përfundoni transaksionin tuaj me ne apo me ofruesin e shërbimit (përkatësisht).

2.2. Transporti Charter

- 2.2.1. Nëse transporti kryhet sipas një marrëveshjeje charter, këto kushte të përgjithshme transporti zbatohen vetëm deri në shkallën ose me ndryshimet e përcaktuara në biletën charter ose në rregulloren charter në nenin 19.

2.3. Mospërputhja ligjore

Në rast se ndonjë prej dispozitave në këto Kushte të përgjithshme transporti kanë mospërputhje me dispozitat e detyrueshme të ndonjë ligji në fuqi, do të zbatohet ligji në fuqi. Megjithatë, do të mbeten të vlefshme dispozitat e tjera të këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit.

2.4. Kushtet e përgjithshme të transportit kanë përparësi mbi Politikat e Wizz Air

Përveçse siç jepet ndryshe në këto Kushte të përgjithshme të transportit, në rast mospërputhjeje mes Kushteve të përgjithshme të transportit dhe politikave të tjera që ne mund kemi me subjekte të veçanta, do të kenë përparësi këto Kushte të përgjithshme të transportit.

2.5. Kushtet e shërbimeve shtesë që nuk përbëjnë plan të udhëtimit

Nëse blini Shërbime shtesë gjatë rezervimit ose shtoni Shërbime shtesë në rezervimin tuaj pas kryerjes së rezervimit tuaj që nuk përbëjnë Udhëtim me paketë, atëherë kontrata për çdo Shërbim shtesë lidhet mes jush dhe Ofruesit përkatës të shërbimit dhe ne nuk do të kemi asnjë detyrim ndaj jush në lidhje me ofrimin e këtyre Shërbimeve shtesë. Çmimi për çdo Shërbim shtesë ofrohet nga Ofruesi përkatës i shërbimit. Nëse ju pranoni një ofertë dhe pagesa kryhet përmes Uebajtit, atëherë pranimi juaj i ofertës na autorizon të bëjmë pagesën e plotë të kostos tek Ofruesi i shërbimit për llogarinë tuaj (nëse aplikohet). Në disa raste tarifa për Shërbimet shtesë është e pagueshme direkt nga ju tek Ofruesi i shërbimit.

3. TARIFAT DHE SHËRBIMET SHITESË

- 3.1. Ne ruajmë të drejtën e ndryshimeve të Tarifave tona. Me kërkesën tuaj juve do t'ju jepet informacion rreth Tarifave tona në Call Center-in tonë.
- 3.2. Punonjësit, punëtorët e shërbimit dhe agjentët tanë janë të detyruar të pajtohen me Tarifat tona.
- 3.3. Tarifat tona në fuqi në kohën e blerjes së shërbimit përkatës do të aplikohen për atë blerje.
- 3.4. **NËSE KRYENI NJË REZERVIM DHE/OSE BLINI NDONJË PREJ SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME TRANSPORTIN AJROR SIÇ PËRCAKTOHET NË UEBSAJT, PRANË AGJENTIT TONË TË BILETAVE NË AEROPORT, MUND T'JU KËRKOHET T'I PAGUANI AGJENTIT TONË NJË TARIFË SHITESË, PËRVEÇ TARIFËS PËRKATËSE TË SHËRBIMIT. INFORMACIONI RRETH TARIFAVE SHITESË QË MBAHEN NGA AGJENTI YNË DISPONOHET PRANË AGJENTIT NË AEROPORT.**

4. ORARI

ORARI I NISJES DHE I MBËRRITJES I SHFAQUR NË ORARIN TONË DHE TJETËRKUND NUK GARANTOHEN DHE NUK PËRBËJNË PJESË TË KONTRATËS SUAJ TË TRANSPORTIT ME NE. NE RUAJMË TË DREJTËN E NDRYSHIMEVE TË TYRE. KËTO NDRYSHIME DO TË JENË NË PËRPUTHJE ME Nenin 15.

5. KONTRATA PËR TRANSPORTIN AJROR

5.1. Lidhja e Kontratës për transportin ajror dhe përmbajtja e saj

Kontrata për transportin lidhet me pagesën e Tarifës totale të fluturimit dhe lëshimit të Itinerarit prej nesh (në përputhje me §5 të Dekretit). Kushtet e Kontratës zbatohen për Kontratën e transportit ajror të lidhur mes jush dhe nesh.

5.2. Itinerari

- 5.2.1. Itinerari (në rastin e transportit të Bagazhit, Etiketa identifikuese e Bagazhit) certifikon lidhjen e Kontratës për transportin ajror mes jush dhe nesh dhe nuk do të lëshohet biletë e veçantë.
- 5.2.2. Ne do të transportojmë vetëm personin (personat) (pra Pasagjerin (Pasagjerët) që ka emrin në Itinerar. Nëse nuk keni një Itinerar kur kryeni checkin-in, duhet të jepni një kod rezervimi. Do t'ju kërkohet të paraqitni Dokument (Dokumente) të vlefshme udhëtimi në momentin e checkin-it.
- 5.2.3. Nëse bëni ndryshime në rezervimin tuaj siç lejohet në këto Kushte të përgjithshme të transportit, ne do t'ju lëshojmë një itinerar të ri si pranim i ndryshimeve tuaja. Në rast të tillë, itinerari i sapolëshuar do të jetë pjesë e Kontratës së transportit që prej lëshimit të tij.
- 5.2.4. Ju mund të kërkoni zëvendësim (ridërgim) të Itinerarit tuaj ose të kodit tuaj të rezervimit duke telefonuar Call Center-in tonë. Wizz Air mund t'ju tarifojë një tarifë për këtë shërbim.

6. REZERVIMI DHE NDEJËSET

6.1. Rezervimi

- 6.1.1. Ju mund të bëni një rezervim përmes Uebsajtit, aplikacionit për celular të Wizz Air ose Call Center-it tonë ose në sportelin e shitjeve në aeroport (nëse aplikohet).
- 6.1.2. Rezervimi nuk do të jetë përfundimtar pa pagesën e Tarifës totale të fluturimit në momentin e rezervimit, përveçse kur përcaktohet këtu ndryshe.
- 6.1.3. Juve ju kërkohet të na jepni neve informacionin e duhur të kontaktit në të cilin mund të kontaktoheni në çdo moment (numrin e telefonit/celularit dhe adresën e emailit). Është përgjegjësia juaj të siguroheni që adresa e dhënë e emailit është e saktë dhe se ju keni akses në të dhe e kontrolloni rregullisht adresën e dhënë të emailit. Është përgjegjësia juaj të siguroheni që numrat e telefonit të dhënë janë të saktë, së bashku me prefiksin e vendit dhe të zonës dhe se jeni i arritshëm në çdo moment në të paktën një prej numrave të telefonit të dhënë gjatë rezervimit tuaj. Wizz Air nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dëmtim që lind nga moszbatimi nga ana juaj i kërkesave të mësipërme.
- 6.1.4. Nëse Rezervuesi nuk është pasagjer ose ai kryen një rezervim edhe për Pasagjerët shoqërues, atëherë konsiderohet se Rezervuesi ka pranuar këto Kushte të përgjithshme transporti për llogari të Pasagjerit (Pasagjerëve) ose të Pasagjerit (Pasagjerëve) shoqërues që kanë emrin në rezervim.
- 6.1.5. Gjithashtu, nëse Rezervuesi nuk është Pasagjer dhe jepen në rezervimin tuaj të dhënat e tij/saj të kontaktit, ju pranoni se Rezervuesi:
 - (a) do të jetë përgjegjës për pranimin dhe transmetimin e çdo komunikimi/korrespondence (duke përfshirë ndryshimet, amendimet dhe anulimet) nga ju te Ofruesit tanë të shërbimit në lidhje me rezervimin të të gjithë Pasagjerët që kanë emrin në rezervim; dhe
 - (b) do të informojë Pasagjerët për çdo njoftim të dërguar nga Wizz Air te Rezervuesi që ndikon te rezervimi.Ju gjithashtu pranoni se, nëse nuk na udhëzoni ndryshe, ne supozojmë se Rezervuesi ka miratimin e çdo Pasagjeri për të marrë çdo rimbursim dhe, aty ku është e zbatueshme, shpenzimet aksidentale ose kompensimin që detyrohet dhe që është i pagueshëm sipas rezervimit.
- 6.1.6. Duke pranuar këto kushte të përgjithshme transporti, rezervuesi konsiderohet se pranon dhe bie dakord se çdo e dhënë personale që na jepet neve për qëllimet e shprehura në politikën e privatësisë dhe, duke na dhënë neve të dhënat e tyre të kontaktit si rezervues dhe/ose duke i dhënë rezervuesit

autoritetin për të vepruar për llogarinë tuaj, ju pranoni përdorimin nga ana jonë të këtyre të dhënave të kontaktit në të gjithë korrespondencën e mëvonshme, mes rezervuesit dhe nesh apo ofruesit tonë të shërbimit. Ju lutemi sigurohuni që të dhënat e kontaktit të Rezervuesit të na jepen me miratimin e Rezervuesit dhe që ato të jenë të sakta, dhe të na njoftoni menjëherë nëse këto të dhëna ndryshojnë.

6.1.7. Kur kryhet një rezervim nga një palë e tretë (duke përfshirë sistemet e rezervimit), pala e tretë (p.sh. agjenti i udhëtimit) do të veprojë si Rezervues. Është detyrimi i Rezervuesit t'ju japë juve të gjitha informacionet përkatëse të rezervimit tuaj (duke përfshirë, por pa u kufizuar me përbërësit e Tarifës totale të fluturimit dhe shumave përkatëse).

6.1.8. Juve ju kërkohet të na jepni emrin e plotë siç shkruhet në Dokumentin tuaj të udhëtimit që do të përdoret për udhëtim. Nëse nuk e bëni këtë gjatë rezervimit ose brenda 2 orëve nga rezervimi përmes Call Center-it tonë, do të paguhet një tarifë ndryshimi emri për korrigjimin e emrit të Pasagjerit, shumën e të cilës është e disponueshme në Uebsajt dhe në Call Center-in tonë.

6.2. Kërkesat e rezervimit

6.2.1. Nëse kërkonit asistencë të veçantë (duke përfshirë, por pa u kufizuar me transportimin e një qeni asistues të pranuar), juve ju kërkohet të na njoftoni rreth aftësisë suaj të kufizuar fizike ose në lëvizje dhe llojin e mjetit ndihmës për lëvizje apo ndihmave të tjera që dëshironi të transportoni ose që keni nevojë, ose çdo ndryshim në to, 48 orë përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit tuaj qoftë duke telefonuar Call Center-in tonë në numrat e dedikuar ose duke përdorur adresën e dedikuar të emailit. Për numrin e telefonit dhe adresën e emailit, ju lutemi vizitoni Uebsajtin.

6.2.2. NËSE NUK JEMI NË GJENDJE TË VERIFIKOJMË GJENDJEN TUAJ SHËNDETËSORE, NËSE KENI NDNJË SËMUNDJE TË RËNDË OSE NGJITËSE, OSE NDNJË PROBLEM TJETËR SHËNDETËSOR QË KËRKON KUJDES MJEKËSOR, ËSHTË PËRGJEGJËSIA JUAJ TË MERRNI KËSHILLË MJEKËSORE NËSE JENI NË GJENDJE FIZIKE TË PËRSHTATSHME PËR TË UDHËTUAR NË MËNYRË TË SIGURT ME AVION. NË PËRPTHJE ME DISPOZITAT E KËTYRE KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË TRANSPORTIT, NE NUK DO TË JEMI PËRGJEGJËS PËR ASNJË AKSIDENT, PËRKEQËSIM TË GJENDJES SHËNDETËSORE QË PËSONI OSE PËR VDEKJEN TUAJ GJATË UDHËTIMIT ME AVION QË NDODHIN PËR SHKAK SE JU NUK KËRKONI OSE NUK NDIQNI KËSHILLËN MJEKËSORE.

6.2.3. Ne rezervojmë të drejtën të kërkojmë certifikatë mjekësore që konfirmon gjendjen fizike të përshtatshme për udhëtim me avion, që përmban miratimin e qartë mjekësor për transportin tuaj ajror, në çdo rast që përmendet në paragrafin 6.2.1 dhe në çdo rast ku ne kemi dyshime të bazuara nëse mund ta përfundoni fluturimin në mënyrë të sigurt, pa kërkuar asistencë të jashtëzakonshme mjekësore gjatë fluturimit. Ne mund të kërkojmë shoqërimin nga mjekët ose infermierët e kualifikuar nëse është e nevojshme. Certifikata mjekësore duhet të lëshohet brenda 6 ditëve nga data e fluturimit.

6.2.4. Nëse dështoni në plotësimin e kërkesave të përcaktuara në Nenet 6.2.1, 6.2.2 dhe 6.2.3, ose në rast se nuk jemi në gjendje të ofrojmë kushtet e përcaktuara në certifikatën tuaj mjekësore në avionin që përdorim sipas Orarit, ne do të anulojmë rezervimin dhe transportin tuaj dhe do t'ju rimbursojmë Tarifën e fluturimit pas zbritjes së Tarifës për Shërbimet e tjera dhe Tarifës për ruajtjen e ndenjësës.

6.2.5. Nëse dëshironi të transportoni Bagazhe speciale ose artikuj me transport të kushtëzuar, ju duhet të informoni Call Center-in tonë përkatësisht (shikoni Nenin 14.4). Për më shumë informacion, vizitoni faqen tonë të internetit.

6.3. Ndenjëset

6.3.1. Wizz Air aplikon një sistem me ndenjësë të caktuara. Kur ju kryeni checkin-in (qoftë në internet, përmes aplikacionit për celular ose në aeroport), për ju zgjidhet një ndenjësë pa pagesë.

6.3.2. Nëse keni ndonjë preferencë, sipas disponueshmërisë, mund të zgjidhni një ndenjësë duke paguar tarifën përkatëse

a) kur kryeni një rezervim ose

b) nëse e keni kryer rezervimin në internet ose përmes aplikacionit të Wizz Air për celularë; ose c) në aeroport deri në 3 orë përpara orarit të planifikuar të nisjes.

- Ju lutemi vini re se pas checkin-it, vetëm mund ndryshoni vendin e zgjedhur paraprakisht në ndenjësë të caktuar që ndodhen në radhët e para ose në radhët e daljes që ndodhen mbi krahë.
- 6.3.3. Për qëllim të këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit tarifa e pagueshme për përzgjedhjen e ndenjësës konsiderohet si Tarifë për Shërbime të tjera.
- 6.3.4. Ndryshimi i ndenjësës së zgjedhur
- 6.3.4.1. Pas imbarkimit në avion, juve mund t'ju kërkohet që për arsye operacionale ose sigurie të ndryshoni ndenjësën e caktuar. Në këtë rast ju lutemi ndiqni udhëzimet e ekuipazhit të kabinës në lidhje me këtë. Nëse na nevojitet të ndryshojmë përzgjedhjen e ndenjësës së blerë prej jush, do të keni të drejtën e rimbursimit të tarifës që keni paguar për ndenjësën e zgjedhur.
- 6.3.5. Në rast se kërkoni asistencë të posaçme me imbarkimin dhe ndenjësën, shihni nenin 6.2.1. Nëse gjatë rezervimit tregoni se keni aftësi të kufizuara në lëvizje, ju mund të zgjidhni checkin-in në internet, por nuk mund ta printoni Kartën e imbarkimit. Nëse keni zgjedhur checkin-in në internet, kontaktoni me Call Center-in tonë për caktimin e ndenjësës duke telefonuar numrin lokal të telefonit të dedikuar për kërkesat për asistencë speciale ose duke dërguar kërkesën tuaj në adresën e emailit të dedikuar për kërkesat për asistencë speciale (për numrat e telefonit dhe adresën e dedikuar të emailit, vizitoni Uebsajtin tonë). Pas këtij caktimi ndenjëseje, ju mund të printoni Kartën tuaj të imbarkimit. Nëse keni zgjedhur checkin-in në internet dhe e keni kryer checkin-in, por nuk kontaktoni me qendrën tonë telefonik që t'ju caktojë ndenjësën, duhet të paraqiteni në sportelin e checkin-it në aeroport kur do t'ju caktohet një ndenjësë, dhe leja juaj e imbarkimit do t'ju printohet falas (shih nenin 9).
- 6.3.6. Përjashtimet në sistemimin e ndenjësëve
- 6.3.6.1. Për arsye sigurie, disa ndenjësë nuk janë të përshtatshme për të gjithë pasagjerët. Ato që ndodhen në radhën e përparme të avionit, në daljet mbi krahë dhe në radhën e fundit. Për shembull, nëse udhëtoni me fëmijë nuk mund të zgjidhni ndenjësët në radhën e përparme ose në radhën e daljes mbi krahë.
- 6.3.7. Anulimi ose ndryshimet e rezervimit nga Pasagjeri
- 6.3.7.1. Nëse dëshironi të kryeni ndryshime në rezervimin tuaj siç përcaktohet në nenin 6.4 ose ta anuloni prenotimin siç përcaktohet në nenin 6.5, tarifat e paguara prej jush për ndenjësën e caktuar nuk do të rimbursohen dhe zbatohet neni 6.4 ose 6.5 (përkatësisht).
- 6.3.8. Modifikimi nga Wizz Air
- 6.3.8.1. Në rast se (i) Wizz Air ndryshon itinerarin ose datat/oraret e programuara të fluturimit të përfshira në Itinerarin tuaj në përputhje me Nenin 15.1; ose (ii) fluturimi juaj anulohet nga Wizz Air ose vonohet për më shumë se 5 orë dhe keni blerë një ndenjësë në lidhje me rezervimin, dhe për shkak të kësaj ngjarjeje ju zgjidhni a) anulimin e rezervimit tuaj, tarifa që keni paguar për ndenjësën e përzgjedhur do t'ju rimbursohet;
- b) ndryshimin e itinerarit të fluturimit tuaj, ne do ta kalojmë ndenjësën e përzgjedhur në fluturimin e rezervuar sërish ose do t'ju caktojmë një ndenjësë tjetër. Në rastin e fundit, do t'ju vihet në dispozicion vlera e plotë e tarifës që keni paguar për ndenjësën e përzgjedhur për përzgjedhjen dhe blerjen e një ndenjësëje në fluturimin e ri-rezervuar në vend të asaj që ju është caktuar paraprakisht në fluturimin me itinerar të ndryshuar; ose do t'ju rimbursojmë shumën që keni paguar për ndenjësën e përzgjedhur me kërkesën tuaj. Në rastin e fundit, kontaktoni me Call Center-in tonë.

6.4. Ndryshimet e rezervimit nga Pasagjeri

- 6.4.1. Rezervimi siç është në Itinerar nuk mund të transferohet apo të modifikohet ndryshe nga sa përcaktohet më poshtë.
- 6.4.2. Nëse dëshironi të ndryshoni orarin ose itinerarin e fluturimit të përcaktuar në Itinerarin tuaj, ju duhet t'i bëni ndryshimet ose përmes Uebsajtit, ose përmes Call Center-it tonë deri në 3 orë përpara kohës së programuar të nisjes të segmentit të parë në rezervimin tuaj. Nëse rezervimi përfshin më shumë se një segment, juve nuk ju lejohet të ndryshoni itinerarin pasi të keni nisur segmentin e parë. Nëse rezervoni fluturim vajtje-ardhje, ndryshimi i itinerarit duhet të bëhet për të dy segmentet (pra nëse Vendi i nisjes ose Vendi i destinacionit ndryshohet në një segment, ai duhet të ndryshohet edhe në segmentin tjetër përkatësisht).
- 6.4.3. Përveçse kur bini dakord ndryshe me ne, juve do t'ju kërkohet të paguani një tarifë ndryshimi fluturimi dhe diferencën mes Tarifës fillestare të fluturimit dhe Tarifës së re të fluturimit (duke përfshirë

ndryshimet në taksa, pagesa dhe Tarifa për Shërbimet e tjera). Nëse Tarifa e re e fluturimit është më e ulët se fillestarja, nuk ju takon rimbursim përveç taksave dhe tarifave, cilado prej tyre të jetë më e ulëta.

- 6.4.4. Nëse dëshironi të ndryshoni emrin e Pasagjerit, ju duhet t'i bëni ndryshimet përmes Ueb-sajtit ose përmes Call Center-it tonë jo më vonë se 3 orë përpara kohës së programuar të nisjes të segmentit të parë në rezervimin tuaj. Mund t'ju kërkohet të paguani një tarifë për ndryshimin e emrit, vizitoni Ueb-sajtin ose telefononi Call Center-in për detaje. Ndryshimi i emrit lejohet vetëm për të gjitha segmentet e rezervuara në të njëjtin rezervim të evidentuar nga Itinerari.
- 6.4.5. Nëse ndryshoni rezervimin siç përcaktohet më lart, ne do t'ju lëshojmë një Itinerar të ri me ndryshimet e bëra dhe me lëshimin e Itinerarit të ri ai Itinerar i ri i ndryshuar do të jetë pjesë e Kontratës së transportit.

6.5. Anulimi i rezervimit nga Pasagjeri

- 6.5.1. Ju mund ta anuloni rezervimin tuaj deri në katërbëdhjetë (14) ditë përpara kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj. Ju do të keni të drejtën e një rimbursimi të Tarifës totale të fluturimit pas zbritjes së Tarifës së anulimit.
- 6.5.2. Nëse e anuloni rezervimin tuaj brenda katërbëdhjetë (14) ditëve përpara kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj, juve do t'ju rimburohet shuma e Tarifës totale të fluturimit pas zbritjes së Tarifës për Shërbimet e tjera dhe Tarifës për ruajtjen e ndenjësës.
- 6.5.3. Në rastin e vdekjes së një anëtar të afërm të familjes (nëna, babai, gjyshi ose gjyshja, fëmija, nipi ose mbesa, vëllai, motra, bashkëshortja, bashkëshorti, bashkëjetuesi ose bashkëjetuesja) që ndodh brenda një muaji përpara kohës së programuar të nisjes së fluturimit në rezervimin tuaj, me kërkesën e paraqitur brenda 1 muaji nga kjo vdekje, ne do të anulojmë rezervimin tuaj dhe do t'ju paguajmë një rimbursim të Tarifës totale të fluturimit për atë pjesë të transportit që nuk është përdorur, me kusht që ju të paraqisni certifikatë vdekjeje ose një kopje të saj, brenda 7 ditëve nga kërkesa juaj.
- 6.5.4. Në rast se Wizz Air ndryshon itinerarin ose oraret e programuara të fluturimit të përfshira në itinerarin tuaj në përputhje me nenin 15.1, nuk përfshin vendin e ndalimit të rënë dakord ose shton një vend të ri ndalimi, ju mund ta anuloni kontratën dhe keni të drejtën të merrni rimbursim të biletës gjithsej.

7. TARIFA TOTALE E FLUTURIMIT, TAKSAT, PAGESAT DHE TARIFAT PËR SHËRBIMET E TJERA

7.1. Tarifa totale e fluturimit, Tarifa e fluturimit

- 7.1.1. Përveçse kur deklarohet shprehimisht ndryshe nga Wizz Air, Tarifa totale e fluturimit përfshin Tarifën e fluturimit, taksat, pagesat dhe Tarifat për Shërbimet e tjera dhe tarifën për Shërbimet shtesë (nëse ka). Informacioni rreth komponentëve të Tarifës totale të fluturimit dhe shumat e tyre përkatëse do t'ju jepen gjatë procesit të rezervimit në Ueb-sajt ose nga Call Center-i, në varësi të mënyrës së rezervimit.
- 7.1.2. Përveçse kur deklarohet shprehimisht ndryshe, Tarifa e fluturimit përmban vetëm tarifën e transportit nga Vendi i nisjes deri në Vendingun e destinacionit dhe taksat e pagesat përkatëse. Tarifa nuk përfshin shërbimin e transportit tokësor ose mes terminaleve të aeroportit dhe qytetit dhe Tarifat për Shërbimet e tjera të kërkuara prej jush.
- 7.1.3. Shuma e biletës llogaritet në përputhje me shumat në fuqi në ditën e rezervimit në lidhje me transportin e caktuar siç përcaktohet në faqen e internetit. Bileta nuk ndikohet nga ndryshimi i këtyre shumave mes datës së rezervimit dhe datës së nisjes së udhëtimit (përveçse siç përcaktohet në nenet 6.4. dhe 7.2.2).
- 7.1.4. Ne rezervojmë të drejtën të prezantojmë çmime promovionale mes datës së rezervimit dhe asaj të udhëtimit tuaj. Prezantimi i çmimeve promovionale nuk ju jep juve të drejtën të kërkoni diferencën mes Tarifës totale të fluturimit të paguar prej jush për rezervimin tuaj dhe Tarifës totale promovionale të fluturimit.

7.2. Taksat, pagesat dhe Tarifat për Shërbimet e tjera

- 7.2.1. Tarifa e fluturimit në përgjithësi përfshin taksat, tarifat dhe pagesat e vendosura mbi Wizz Air nga qeveritë, autoritetet e tjera ose operatorët e aeroporteve, në fuqi në datën e lëshimit të Itinerarit dhe shumën më të vogël të Tarifave të pashmangshme për Shërbime e tjera që janë të nevojshme për të

kryer rezervimin në nivelet në fuqi në kohën e rezervimit dhe të blerjes. Tarifat e aeroportit për pasagjerin të përfshira në Tarifën e fluturimit përfshijnë pagesat për shërbimet që ju ofrohen nga operatori i aeroportit, që mbulojnë përpunimin e pasagjerëve dhe të bagazheve në territorin e aeroportit, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, checkin-in e pasagjerëve dhe të bagazheve, kontrollin e sigurisë së pasagjerëve, kontrollin e sigurisë së bagazheve, kontrollin e pasaportave dhe imbarkimin. Çdo taksë dhe pagesë e vendosur nga një operator aeroporti, edhe nëse bazohen në numrin e pasagjerëve, është e parimbursueshme.

- 7.2.2. Ne ruajmë të drejtën të kërkojmë, dhe duke pranuar këto Kushte të përgjithshme transporti, ju pranoni se do të paguani çdo shumë të re ose të rritur të taksave, pagesave ose tarifave (duke përfshirë Tarifat për Shërbimet e tjera) në lidhje me udhëtimin tuaj të vendosura nga qeveritë, autoritetet e tjera ose nga operatorët e aeroportit, mes datës së lëshimit të Itinerarit dhe asaj të udhëtimit tuaj, me efekt prapaveprues, sipas rastit. Nëse nuk i paguani këto shuma ne kemi të drejtën t'ju refuzojmë transportin në përputhje me nenin 12. Në rast se Tarifa totale e fluturimit rritet në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i një shume të re ose të rritur të taksave, pagesave ose tarifave të vendosura nga qeveritë, autoritetet e tjera ose operatorët e aeroporteve, ju keni të drejtën të anuloni rezervimin tuaj dhe të merrni rimbursim të Tarifës totale të fluturimit.
- 7.2.3. Disa shërbime mund të blihen prej jush pasi të kryhet rezervimi, por në çdo rast përpara nisjes së udhëtimit në faqen e internetit ose - sipas nenit 3.4 - në aeroport, në varësi të llojit të shërbimit. Çdo Tarifë për Shërbimet e tjera, të tilla si përzgjedhja e ndenjësës mund të ndryshojë pas ditës së rezervimit. Tarifat për Shërbimet e tjera do të jenë Tarifa për Shërbimet e tjera të zbatueshme në datën e blerjes, që janë të disponueshme nga Uebsajti ynë ose nga Call Center-i ynë.

7.3. Monedha e Tarifës së fluturimit

- 7.3.1. Tarifa e fluturimit, taksat, pagesat dhe Tarifat për Shërbimet e tjera do të përcaktohen në monedhën e Vendit të nisjes, përveçse kur ne përcaktojmë një monedhë tjetër gjatë pagesës ose përpara pagesës (p.sh. për shkak të moskëmbueshmërisë së monedhës së Vendit të nisjes) ose ju zgjidhni të paguani në një monedhë tjetër. Fatura lëshohet në monedhën e vendit të nisjes.
- 7.3.2. Çmimet e treguara në një monedhë të caktuar në Uebsajtin tonë janë të vlefshme vetëm nëse ajo monedhë është monedha e Vendit të nisjes siç përcaktohet nga ne. Nëse zgjidhni të paguani në një monedhë tjetër, çmimi do të konvertohet prej nesh.

7.4. Pagesa

7.4.1. Të përgjithshme

- 7.4.1.1. Pagesa e tarifës totale të fluturimit do të kryhet me kartë debiti ose krediti ose me mjet tjetër siç ju informojmë në faqen e internetit (p.sh. me kuponët dhuratë të Wizz) me rezervimin ose me transfertë bankare për udhëtimet që nisen në vende të caktuara (shih nenin 7.4.3). Në disa raste të veçanta, për të cilat do të njoftoheni në momentin e rezervimit, do t'ju kërkohej të paguani taksat dhe tarifave veçmas, sipas kërkesës (disa aeroporte mund të kërkojnë pagesën e tarifave të aeroportit në aeroport).
- 7.4.1.2. Ju jeni përgjegjës për pagesën e Tarifës totale të fluturimit edhe nëse Tarifa totale e fluturimit është paguar nga një palë e tretë. Karta e debitit ose e kreditit e përdorur për pagesën ose pagesa me transfertë bankare dhe/ose të dhënat e rezervimit mund të konsiderohen prej nesh sipas gjykimit tonë se përmbajnë rrezik të lartë mashtrimi. Në rast të tillë, ne do t'ju kontaktojmë përmes numrave të telefonit që keni dhënë gjatë rezervimit tuaj për verifikimin e rezervimit dhe detajeve të pagesës. Nëse nuk jemi në gjendje të krijojmë kontakt përmes atyre numrave, ose nuk mund të verifikojmë pagesën ose të dhënat e rezervimit, ne rezervojmë të drejtën të anulojmë rezervimin tuaj dhe t'ju rimbursojmë Tarifën totale të fluturimit.
- 7.4.1.3. Duke pranuar Kushtet e përgjithshme të transportit, ju bini dakord shprehimisht që ne mund të lëshojmë një faturë elektronike në lidhje me Tarifën totale të fluturimit dhe dhënien e kësaj fature elektronike vetëm përmes mjeteve elektronike dhe vetëm në adresën e emailit të dhënë prej jush gjatë rezervimit.
- 7.4.1.4. Faturat elektronike lëshohen në përputhje me rregulloret përkatëse ligjore hungareze (në veçanti klauzola 167 e "Ligjit hungarez Nr. C të vitit 2000 mbi Kontabilitetin").

- 7.4.1.5. Gjithashtu, mund të kërkohet një kopje fizike e faturës elektronike përmes Call Center-it, kundrejt një tarife, shuma e së cilës jepet në uebsajtin tonë ose mund të jepet nga Call Center-i ynë. Kjo kopje e printuar e faturës do t'ju dërgohet me postë në adresën që ju i keni dhënë Call Center-it. Ju mund të kërkoni edhe një faturë të modifikuar që përmban hollësi të ndryshme të faturimit, përveç atyre që jepen pas rezervimit, për të cilat mund të kërkohet një tarifë.
- 7.4.1.6. Pagesa e Tarifës totale të fluturimit do të kryhet në monedhën në të cilën është përcaktuar Tarifa e fluturimit, përveçse kur bihet dakord ndryshe.
- 7.4.1.7. **NËSE PAGUANI ME KARTË DEBITI OSE KREDITI, PAGESA JUAJ DO TË PËRPUNOHET PËRMES NJË SISTEMI NDËRKOMBËTAR PËRPUNIMI PËR PAGESAT ME KARTA. JU MUND TË KONSTATONI SE SHUMA E TARIFUAR NË KARTËN TUAJ TË DEBITIT OSE TË KREDITIT ËSHTË E NDRYSHME (DHE MUND TË JETË MË E MADHE) NGA ÇMIMI PËRFUNDIMTAR NË KONFIRMIMIN E REZERVIMIT TONË SI REZULTAT I DIFERENCAVE TË KONVERTIMIT VALUTOR NË SISTEMIN NDËRKOMBËTAR TË PËRPUNIMIT PËR PAGESAT ME KARTA.**
- 7.4.2. Pagesa në rast rezervimi në internet. Ju duhet të paguani Tarifën totale të fluturimit me një kartë banke të përshtatshme për pagesat në internet kur kryeni rezervimin në internet, ose me transfertë bankare (nëse është e mundur për rezervimin përkatës) brenda periudhës kohore të përcaktuar në Uebsajt.
- 7.4.3. Pagesa nëse rezervimi kryhet nga Call Center-i ynë. Nëse kryeni një rezervim përmes Call Center-it tonë, ju duhet t'i jepni agjentit të Call Center-it të dhënat e kartës suaj dhe ai do të përgatisë pagesën. Pagesa e Tarifës totale të fluturimit duhet të kryhet në momentin e rezervimit. Në raste të caktuara, mund të paguani me transfertë bankare, detajet e të cilës janë të disponueshme në faqen tonë të internetit dhe në qendrën tonë telefonike (shih nenin 7.4.4). Aplikohet një tarifë shtesë për rezervimet që kryhen përmes Call Center-it tonë, detajet e së cilës janë të disponueshme në Uebsajtin tonë ose duke telefonuar Call Center-in tonë.
- 7.4.4. Pagesa me transfertë bankare
- 7.4.4.1. Transferta bankare disponohet për pagesën e Tarifës totale të fluturimit për udhëtimet që nisen nga vende të caktuara. Për detaje, këshillohuni me Uebsajtin tonë.
- 7.4.4.2. Ju jeni përgjegjës për kostot apo tarifat e vendosura në lidhje me një pagesë me transfertë bankare. Shuma që transferoni dhe që merrni duhet të mbulojë shumën e plotë dhe të saktë të Tarifës totale të fluturimit dhe duhet të merret prej nesh brenda afatit kohor të përcaktuar në Uebsajtin tonë. Nëse nuk e marrim shumën e plotë të Tarifës totale të fluturimit brenda afatit kohor të specifikuar, Rezervimi juaj nuk do të jetë i vlefshëm dhe do të fshihet.
- 7.4.4.3. Për pagesë me transfertë bankare periudha kohore për kryerjen e rezervimeve është e kufizuar.
- 7.4.5. Nëse nuk merrni konfirmim të Rezervimit tuaj nga ne brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së Rezervimit në adresën e emailit të dhënë në momentin e rezervimit, ju duhet të kontaktoni me Call Center-in tuaj për të verifikuar vlefshmërinë e rezervimit.
- 7.4.6. Nëse nuk specifikohet ndryshe nga Wizz Air, numri i rezervimeve të lidhura njëkohësisht me një llogari Wizz të pagueshme me transfertë bankare është i kufizuar.
- 7.4.7. Ne do të kthejmë çdo pagesë të pidentifikuar te llogaria bankare nisëse. Çdo kosto që shoqërohet me një transfertë të tillë bankare do të mbartet prej jush.

8. MBROJTJA E TË DHËNAVE

- 8.1. Ne veprojmë në përputhje me ligjet përkatëse të mbrojtjes së të dhënave në lidhje me të dhënat tuaja personale. Politika jonë e privatësisë ofrohet në faqen tonë në internet ose, me kërkesën tuaj, mund të merret informacion i detajuar nga Call Center-i ynë.
- 8.2. Ju e pranoni deklaratën e privatësisë duke lidhur kontratën dhe duke pranuar këto kushte të përgjithshme të transportit.

9. CHECKIN-i DHE IMBARKIMI

- 9.1. Nëse nuk jeni në gjendje të udhëtoni për çfarëdo arsye, ose nuk arrini të paraqiteni në checkin ose në portën e imbarkimit në kohë për çfarëdo arsye, ne (sipas nenit 9.16) do të refuzojmë transportimin tuaj, do të anulohet rezervimin dhe, me kërkesën tuaj ndaj nesh, do t'ju rimburojmë shumën e tarifës totale të fluturimit pas zbritjes së shumave të tarifave për shërbime të tjera dhe tarifës për ruajtjen e ndenjësës. Ju sugjerojmë të blini sigurim kundër anulimit.

- 9.2. Duhet të vërtetoni identitetin tuaj, të paraqisni kodin e rezervimit dhe dokumentet e vlefshme të udhëtimit, siç kërkohen sipas nenit 11, në momentin e checkin-it. Nëse nuk e bëni këtë, ne do të refuzojmë transportimin tuaj, do të anulojmë rezervimin dhe, me kërkesën tuaj ndaj nesh, do t'ju rimbursojmë shumën e Tarifës totale të fluturimit pas zbritjes së shumave të Tarifave për Shërbime të tjera dhe Tarifës për ruajtjen e ndenjës.
- 9.3. Në disa aeroporte, në checkin Pasagjerit mund t'i bëhet fotografi për arsye sigurie dhe ju bini dakord që t'ju bëhet kjo fotografi.
- 9.4. Nëse Itinerari juaj lëshohet për dy ose më shumë segmente për një drejtim, pas mbërritjes në secilin aeroport tranziti, juve ju kërkohet të dilni nga avioni, të hyni në atë vend (të kaloni përmes doganës, kontrollit të sigurisë dhe kontrollit kufitar), të merrni Bagazhin tuaj të regjistruar dhe të kryeni checkin-in në fluturimin e radhës sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme të transportit.
- 9.5. Checkin-i në aeroport nis 2 orë dhe mbyllet, zakonisht, 40 minuta përpara kohës së nisjes sipas Orarit në aeroportin e Vendit të nisjes. Në aeroporte të caktuara, detajet e të cilave mund të merren në Uebsajtin tonë ose nga Call Center-i ynë, checkin-i mbyllet 60 minuta përpara kohës së nisjes sipas Orarit.
- 9.6. Checkin-i në internet dhe checkin-i përmes aplikacionit për celular të Wizz Air është i disponueshëm në itinerare të caktuara. Nëse disponohet checkin-i në internet, ju duhet të zgjidhni kur kryeni rezervimin tuaj nëse do të kryeni checkin-in në internet apo në aeroport. Nëse zgjidhni checkin-in në aeroport, ne do t'ju tarifojmë një tarifë të parimbursueshme përpunimi, të pagueshme në momentin e rezervimit. Nëse, në kohën e rezervimit, keni zgjedhur checkin-in në internet, mund të vendosni më vonë ta kryeni checkin-in në aeroport, por në rast të tillë do t'ju tarifohet një tarifë përpunimi, e pagueshme në aeroport. Shuma e këtyre tarifave përpunimi të aeroportit disponohet në Uebsajt ose nga Call Center-i ynë.
- 9.7. Përveçse kur bihet dakord ndryshe prej nesh, nëse keni zgjedhur të përdorni checkin-in në internet për fluturimin tuaj, mund të kryeni checkin-in nga 48 orë deri në 3 orë përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit. Checkin-i në internet është gjithmonë i disponueshëm përmes Uebsajtit ose aplikacionit të Wizz Air për celular.
- 9.8. Nëse keni kryer checkin-in në internet në Uebsajt, ju duhet të printoni ose të shkarkoni Kartën e imbarkimit jo më vonë se 2 orë përpara kohës së nisjes sipas Orarit. Nëse keni kryer checkin-in përmes aplikacionit për celular të Wizz Air, duhet ta shkarkoni Kartën e imbarkimit për celular në Passbook në pajisjen tuaj celulare ose në një aplikacion tjetër me funksione të ngjashme jo më vonë se 2 orë përpara kohës së nisjes sipas Orarit. Në të dyja rastet, ju duhet të paraqisni Kartën e imbarkimit të printuar ose të shkarkuar së bashku me Dokumentet tuaja të vlefshme të udhëtimit të përdorura gjatë checkin-it në internet të kontrollit të sigurisë i aeroportit dhe të porta e imbarkimit.
- 9.9. Nëse keni kryer checkin-in në internet ose përmes aplikacionit të Wizz Air, dhe keni Bagazhe të regjistruara, duhet të paraqiteni bashkë me bagazhet tuaja të sporteli i lënies së bagazheve jo më vonë se 40 minuta përpara Kohës së nisjes së programuar të fluturimit, nëse nuk specifikohet ndryshe. Në disa aeroporte sporteli i checkin-it funksionon edhe si sporteli i lënies së bagazheve.
- 9.10. Nëse nuk e shkarkoni Kartën tuaj të imbarkimit për celular ose nuk e printoni Kartën tuaj të imbarkimit (në rastin e checkin-it në internet) ose nuk mund ta paraqitni Kartën e imbarkimit në portën e imbarkimit për ndonjë arsye tjetër, mund të kryeni checkin-in në aeroport kundrejt pagesës së tarifës së checkin-it në aeroport.
- 9.11. Ju duhet të paraqiteni në portën e imbarkimit për imbarkim jo më vonë se 30 minuta përpara Kohës së nisjes së programuar të fluturimit. Nëse nuk paraqitni në portën e imbarkimit Kartën tuaj të imbarkimit dhe/ose të njëjtat Dokumente udhëtimi të përdorura në checkin, ne mund të refuzojmë transportin.
- 9.12. Nëse e keni kryer tashmë checkin-in në internet ose përmes aplikacionit për celular të Wizz Air:
- (i) ndryshimet e emrit, datës së fluturimit, orarit të fluturimit dhe itinerarit mund të bëhen deri në 4 orë përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit (kundrejt, nëse aplikohet, pagesës së çdo tarife ndryshimi siç detajohet në Uebsajtin tonë ose të disponueshme nga Call Center-i ynë);

- (ii) shërbime shtesë mund të shtohen në internet ose përmes aplikacionit të Wizz Air për celular përmes tarifës së përshtatshme të shërbimit deri në 3 orë përpara Kohës së programuar të nisjes. Nëse ato shtohen në aeroport, është e pagueshme tarifa e shërbimit e aplikueshme për blerjen në aeroport. Informacionet mbi shërbimet e disponueshme për blerje pas checkin-it dhe tarifën përkatëse janë të disponueshme në Uebsajtin tonë, pranë Call Center-it tonë ose nga agjenti juaj i udhëtimit.
 - (iii) nëse shtoni shërbime shtesë pas kryerjes së checkin-it në internet ose përmes aplikacionit për celular, duhet të riprintoni Kartën e imbakimit ose duhet të shkarkoni sërish Kartën e imbakimit për celular (përkatësisht) duke treguar shërbimet shtesë dhe duke e paraqitur atë së bashku me Dokumentet tuaja të vlefshme të udhëtimit te kontrolli i sigurisë së aeroportit dhe te porta e imbakimit.
- 9.13. Për fëmijët nën 14 vjeç duhet (a) të kryhet checkin-i (qoftë në internet ose përmes aplikacionit për celular) dhe (b) të jenë të shoqëruar, në çdo rast nga një Pasagjer mbi 16 vjeç. Në disa vende rregulloret në lidhje me udhëtimin e të miturve mund të jenë më të rrepta se më lart dhe në këtë rast aplikohen ato rregullore
- 9.14. Pavarësisht dispozitave të nenit 9.7, nëse kryeni checkin-in në internet ose përmes aplikacionit për celularë, por nuk jeni qytetar i BE-së/ZEE-së, duhet të paraqiteni personalisht në sportelin e checkin-it të paktën 40 minuta përpara kohës së nisjes së fluturimit sipas orarit me dokumentet tuaja të udhëtimit dhe ta verifikoni atje lejen e imbakimit. Nëse nuk paraqisni Kartën e verifikuar të imbakimit në portën e imbakimit, ne mund të refuzojmë transportin.
- 9.15. Kur udhëtoni drejt Vendeve të caktuara të destinacionit, duhet të jepni informacione rreth Dokumenteve tuaja të udhëtimit në internet përmes Uebsajtit tonë për të qenë në pajtim me rregulloret vendase, jo më vonë se 4 orë përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit sipas Orarit. Nëse nuk e bëni këtë, ne mund t'ju refuzojmë transportin.
- 9.16. Fluturimet e humbura
- 9.16.1. Nëse humbni fluturimin, ne mund t'ju transferojmë në fluturimin tonë të disponueshëm të radhës drejt Vendit tuaj të destinacionit, me kusht që:
- (i) të ndodheni në Vendin e nisjes dhe ta kërkonti këtë transfertë nga agjenti ynë i biletave në aeroport brenda 30 minutave pas kohës së programuar të nisjes së fluturimit tuaj fillestar, sipas Orarit; dhe
 - (ii) nëse keni kryer checkin në Uebsajt ose duke përdorur aplikacionin e Wizz Air për celular,
 - të mos keni arritur afatin e checkin-it me bagazhet tuaja nëse keni bagazhe të regjistruara ose
 - të mos keni arritur kohën e imbakimit në portë; ose
 - (iii) nëse keni zgjedhur checkin-in në aeroport, të jeni paraqitur në Vendin e nisjes por të mos keni arritur Afatin e checkin-it; dhe
 - (iv) të keni paguar Tarifën e fluturimit të humbur në aeroport tek agjenti ynë i biletave.
- 9.16.2. Nëse e transferoni fluturimin tuaj fillestar siç përshkruhet këtu në nenin 9.16 dhe keni zgjedhur checkin-in në aeroport për fluturimin e riprenotuar, ne do t'ju tarifojmë një tarifë të parimbursueshme përpunimi, e pagueshme në kohën e riprenotimit, përveç tarifës së fluturimit të humbur.
- 9.16.3. Nëse keni zgjedhur checkin-in në aeroport dhe keni kryer checkin-in në kohë, por nuk keni arritur kohën e imbakimit në portë, atëherë duhet të bëni një rezervim të ri. Riprenotimi sipas këtij neni 9.16 nuk lejohet në raste të tilla.
- 9.16.4. Nëse e riprenotoni fluturimin në përputhje me këtë nen 9.16, atëherë neni 9.1 nuk do të aplikohet dhe tarifa totale e fluturimit tuaj fillestar nuk do të rimbursohet.

10. ZHDOGANIMI DHE KONTROLLI I SIGURISË

- 10.1 Duhet të kryeni të gjitha formalitetet e emigracionit ose formalitetet e tjera të sigurisë dhe zhdoganimet e kërkuara për fluturimin tuaj. Nëse nuk i respektoni këto kërkesa, ne do të refuzojmë transportimin tuaj, do të anulojmë rezervimin dhe, me kërkesën tuaj ndaj nesh, do t'ju rimburojmë Tarifën totale të fluturimit pas zbritjes së shumave të Tarifave për Shërbime të tjera dhe Tarifës për ruajtjen e ndenjës.
- 10.2 Duhet t'u nënshtroheni kontrolleve të sigurisë që kryhen nga autoritetet shtetërore dhe aeroportuale të vendeve të prekura nga transporti, nga operatori i aeroportit dhe nga operatori i fluturimit.
- 10.3 Nëse e kërkon ligji i vendeve të prekura nga transporti, duhet të jeni i pranishëm gjatë inspektimit të bagazheve tuaja që kryhet nga autoritetet doganore ose zyrtarët e tjerë të autoriteteve.
- 10.4 Deri në masën e lejuar nga ligji, ne refuzojmë çdo përgjegjësi për dëmet që lindin nga inspektimet e përcaktuara në nenin 10 të këtij dokumenti dhe/ose refuzimi juaj për t'iu nënshtuar vetë ose bagazhet tuaja këtyre inspektimeve.

11. DOKUMENTET E UDHËTIMIT

- 11.1 Duhet të keni të gjitha dokumentet e nevojshme për hyrjen, daljen, dokumentet mjekësore dhe dokumente të tjera të kërkuara nga vendet e prekura nga transporti dhe për të qenë në përputhje me rregullat dhe rregulloret përkatëse të vendeve të prekura nga transporti. Dokumenti i udhëtimit që përdorni për kontrollin kufitar dhe imbarkimin duhet të jetë i njëjti që përdoret për check-in-in. Ne nuk jemi përgjegjës për ekzistencën, pronën dhe vlefshmërinë e Dokumenteve tuaja të udhëtimit. Nëse nuk i plotësoni këto kërkesa ose nëse Dokumentet tuaja të udhëtimit janë të papërshtatshme ose të paplota, ne refuzojmë çdo përgjegjësi për çdo dëm që lind si rezultat.
- 11.2 Nëse ju kërkohet të keni vizë për të hyrë në vendin e aeroportit të transitit, duhet ta keni një të tillë në mbërritje. Nëse nuk e respektoni këtë kërkesë, ne nuk do të jemi përgjegjës për ndonjë dëm si rezultat i kësaj.
- 11.3 Nëse ne detyrohemi të paguajmë ndonjë gjobë, penalitet ose nëse na shkaktohet ndonjë shpenzim për shkak të mospajtitim tuaj me rregullat e përmendura në nenin 11.1-11.2, ju duhet të na i rimburosoni këto kosto pas kërkesës sonë. Ju gjithashtu do t'i mbuloni kostot e transportit nga shteti që nuk lejon hyrjen. Ne nuk do t'ju rimburojmë pjesën e tarifës që lidhet me transportin drejt shtetit që nuk ju lejon hyrjen.
- 11.4 Përveçse siç përcaktohet në Kodin Civil Hungarez, ne nuk jemi përgjegjës për refuzimin e transportit tuaj nëse besojmë në mënyrë të arsyeshme se ligji dhe rregulloret përkatëse nuk e lejojnë transportin tuaj.

12. REFUZIMI I TRANSPORTIT

- 12.1 Përveç rrethanave të tjera të përcaktuara në nenet e tjera të këtyre kushteve të përgjithshme të transportit, ne rezervojmë të drejtën t'ju refuzojmë transportin juve dhe bagazheve tuaja, veçanërisht nëse:
- kemi arsye të besojmë se refuzimi i transportit është i nevojshëm për arsye sigurie (p.sh. jeni i intoksikuar);
 - kemi arsye të besojmë se transporti mund të rrezikojë jetën, shëndetin, integritetin fizik dhe komoditetin tuaj dhe/ose të atyre në bord;
 - kemi arsye të besojmë se mosha juaj, gjendja juaj mendore ose fizike mund t'ju rrezikojnë juve dhe/ose ata që ndodhen në bord, ose pronën e tyre;
 - gjendja juaj fizike, rrobat tuaja ose sjellja juaj frikësojnë, neverisin ose skandalizojnë ata që janë në bord;
 - keni shkelur kodin e sjelljes në një fluturim të mëparshëm dhe kemi arsye të besojmë se do ta përsërisni sjelljen;
 - ju kemi njoftuar më parë se nuk do t'ju transportojmë në asnjë rast në fluturimet tona;
 - mund t'ju kemi refuzuar gjithashtu edhe rezervimin;
 - keni refuzuar të kryeni formalitetet e emigracionit dhe/ose doganore;
 - keni refuzuar të nënshtroheni veten ose Bagazhet tuaja ndaj kontrollit të sigurisë;
 - nuk keni paguar Tarifën përkatëse të fluturimit, taksat, pagesat ose Tarifat për Shërbimet e tjera;

- k. na detyroheni para në lidhje me një fluturim (fluturime);
- l. kemi arsye të besojmë se refuzimi i transportit është i nevojshëm për të qenë në pajtim me rregullat dhe rregulloret e ndonjë prej Vendeve të prekura nga Transporti;
- m. nuk keni një Kartë imbarkimi të vlefshme ose Dokumente udhëtimit të vlefshme (duke përfshirë shkatërrimin e këtyre dokumenteve gjatë transportit) ose nuk paraqitni në imbarkim Dokumentet e udhëtimit të përdorura në checkin-in në internet ose nëse nuk jeni qytetar i BE-së/ZEE-së dhe keni përdorur checkin-in në internet, nuk keni paraqitur një leje imbarkimi të vulosur në sportelin e imbarkimit;
- n. ju nuk plotësoni ose kemi arsye të besojmë se nuk plotësoni kërkesat e hyrjes në shtetin e Vendit të ndalimit të rënë dakord ose të Vendit të destinacionit (duke përfshirë mosdhënien e informacionit rreth Dokumenteve tuaja të udhëtimit jo më vonë se 4 orë përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit përmes Uebsajtit tonë kur udhëtoni drejt Vendeve të destinacioneve ku kjo është e detyrueshme);
- o. ju përpiqeni të hyni në një shtet përmes të cilit mund të kaloni vetëm si tranzit;
- p. ju refuzoni të na dorëzoni neve ose autoriteteve kompetente Dokumentet tuaja të udhëtimit, kundrejt një vërtetimi marrjeje, kur ju kërkohet;
- q. nuk arrini të vërtetoni se jeni personi i emërtuar në rezervim; veçanërisht nëse emri në rezervim nuk është identik me emrin në Dokumentin e udhëtimit që paraqitet në aeroport.
- r. nuk na keni informuar rreth nevojave të veçanta ose rreth qëllimit tuaj për të transportuar një Bagazh special ose artikull me transport të kushtëzuar;
- s. keni nevojë për mbështetje të veçantë që ne nuk mund t'jua ofrojmë ose mund të na sjellë shpenzime jashtëzakonisht të larta.
 - 12.2 Nëse sjellja juaj përbën dyshim të arsyeshëm për keqbërje ose krim, ose nëse pini duhan në bord, ne do të nisim procedurë ligjore me autoritetet kompetente. Ne rezervojmë gjithashtu të drejtën të refuzojmë transportim e mëtejshëm tuajin ose të Bagazhit tuaj dhe t'ju anulojmë rezervimin (rezervimet).
 - 12.3 Nëse ne, duke ushtruar gjykimin tonë në mënyrë të arsyeshme, refuzojmë transportin tuaj ose anulojmë rezervimin tuaj në bazë të këtij neni ose të nenit 13.3.4 ose 13.3.6, nëse na kërkohet prej jush përmes qendrës sonë telefonik, ne do të rimbursojmë tarifën totale të fluturimit pas zbritjes së shumave të tarifës për shërbimet e tjera dhe tarifës për ruajtjen e ndenjësës. Ne nuk do të jemi përgjegjës për asnjë humbje të pësuar për shkak të këtij refuzimi për transport.
 - 12.4 Në disa vende rregulloret në lidhje me refuzimin e transportit mund të jenë më të rrepta se më lart dhe në këtë rast aplikohen ato rregullore.

13. RREGULLAT SPECIALE QË APLIKOHEN PËR TRANSPORTIN AJROR TË PASAGJERËVE

13.1 Transporti i Pasagjerëve me nevoja të veçanta

- 13.1.1. Nëse keni nevoja të veçanta, duhet të na njoftoni (shikoni Nenin 6.2).
- 13.1.2. Në bordin e të njëjtit avion mund të transportohet një maksimum prej 28 Pasagjerësh me aftësi të kufizuara ose me aftësi të kufizuara në lëvizje, duke përfshirë një maksimum prej 10 Pasagjerësh që kërkojnë karrocë invalidi nga checkin-i në ndenjësën në kabinë.
- 13.1.3. Gratë shtatzëna nuk mund të udhëtojnë në fluturimet tona pas javës së 34-t të shtatzënisë. Në rastin e shtatzënie me binjakë, kufiri përkatës kohor është java e 32-të e shtatzënisë. Gratë që janë mbi javën e 28-të të shtatzënisë mund të udhëtojnë në fluturimet tona vetëm nëse na paraqesin certifikatë mjekësore që konfirmon gjendjen e tyre fizike të përshtatshme për udhëtim ajror. Ne do të jemi përgjegjës vetëm sipas këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit për shqetësimet shëndetësore të gratë shtatzëna dhe/ose fëmijën e tyre të palindur që mund të ndodhin gjatë ose si rezultat i transportit ajror. Certifikata mjekësore duhet të lëshohet brenda 6 ditëve nga data e fluturimit.
- 13.1.4. Ne nuk pranojmë Pasagjerë në barela.
- 13.1.5. Koncentruesit portativë të oksigjenit (POC-të) që nuk përmbajnë gaz të ngjeshur ose oksigjen të lëngshëm mund të merren në bord, me kusht që të jepen prova rreth natyrës së pajisjes. Këto POC përfshijnë Continuous Positive Airway Pressure (CPAP) që përmban një pajisje ventilimi që fryn

një fluks të butë ajri në hundë për të mbajtur rrugët e frymëmarrjes të hapura; por nuk përmban oksigjen. Këto pajisje janë të përjashtuara nga Politika jonë e Bagazheve të paregjistruara dhe mund të merren në bord si artikull shtesë. Nëse e transportoni këtë pajisje në bord, ju lutemi kontaktoni me Call Center-in tonë të paktën 48 orë përpara nisjes së programuar të fluturimit tuaj. Për më shumë informacion, vizitoni faqen tonë të internetit.

13.1.6. Aparatet e frymëmarrjes që përmbajnë gaz të ngjeshur ose oksigjen të lëngshëm nuk mund të merren në bord.

13.1.7. Ne nuk i pranojmë pasagjerët që udhëtojnë me oksigjenin e tyre, por do t'u ofrojmë oksigjen mjekësor atyre pasagjerëve që kanë kërkuar asistencë speciale gjatë fluturimit.

Nëse keni nevojë për këtë asistencë, ju lutemi kontaktoni me Call Center-in tonë të paktën 48 orë përpara nisjes së programuar të fluturimit tuaj për të përgatitur këtë shërbim. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni Uebsajtin tonë ose kontaktoni me Call Center-in tonë.

13.2 Transporti i Foshnjave dhe personave nën 14 vjeç

13.2.1. Foshnjat nën moshën 2 vjeçare mund të udhëtojnë në prehrin e prindërve. Me çdo të rritur lejohet të udhëtojë vetëm një i mitur. Për arsye sigurie, në bordin e të njëjtit avion mund të transportohet një maksimum prej 15 Foshnjash. Tarifat e tarifuara për transportin e Foshnjave disponohen në Uebsajt ose nga Call Center-i ynë.

13.2.2. Nëse rezervim juaj është për udhëtim vajtje-ardhje, dhe Foshnja mbush dy vjeç përpara datës së segmentit të kthimit, duhet të kryhet një rezervim i veçantë për udhëtimin e kthimit, sepse fëmija nuk do të konsiderohet më Foshnjë.

13.2.3. Fëmijët nën moshën 14 vjeç duhet të shoqërohen nga një person që është të paktën 16 vjeç. Ne nuk pranojmë persona të pashoqëruar nën 14 vjeç. Një person mbi 16 vjeç lejohet të shoqërojë një maksimum prej 10 personash nën moshën 14 vjeç. Në disa vende rregulloret në lidhje me udhëtimin e të miturve mund të jenë më të rrepta se më lart, në këtë rast zbatohen ato rregullore.

13.2.4. Ne nuk transportojmë fëmijë nën moshën 14 vjeç në ditën e udhëtimit.

13.3 Sjellja në bord

13.3.1 Ju duhet të respektoni udhëzimet e Ekuipazhit në çdo moment gjatë transportit.

13.3.2 Për arsye sigurie, ne mund të ndalojmë përdorimin e pajisjeve elektronike, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, telefonat celularë, laptopët, regjistruarit portativë, radiot portative, lexuesit CD, lojërat elektronike ose pajisjet transmetuese, lodrat e telekomanduara dhe radiomarrëset në bordin e avionit. Lejohet përdorimi i aparateve të dëgjimit dhe i simuluesve kardiale, ndërsa pajisjet e tjera portative elektronike mund të përdoren vetëm në regjimin e fluturimit.

13.3.3 Për arsye sigurie, juve ju lejohet të konsumoni vetëm pijet alkoolike të blera në bord.

13.3.4 A duhet

- a) sipas gjykimit të arsyeshëm të Ekuipazhit, të rrezikoni me sjelljen tuaj sigurinë e avionit ose të personave në bord dhe të pronës së tyre;
- b) abuzoni verbalisht ose fizikisht me pjesëtarët e Ekuipazhit ose i pengoni ata të kryejnë detyrat e tyre;
- c) nuk respektoni udhëzimet e Ekuipazhit (duke përfshirë paralajmërimet mbi konsumin e alkoolit, drogës, duhanit dhe mbi përdorimin e pajisjeve elektronike);
- d) bezdisni ose u shkaktoni shqetësime, dëme apo lëndime personave në bord,

ne kemi të drejtën të zbatojmë çdo masë të nevojshme, duke përfshirë edhe forcën, që konsiderohet e nevojshme për të parandaluar ose ndaluar këtë sjellje, dhe ju do të na dëmshpërbleni për çdo dëmtim apo kosto që lind si rezultat i sjelljes suaj. Ne rezervojmë të drejtën të zbatojmë këtë pretendim në një padi dhe të refuzojmë transportin e mëtejshëm tuajin dhe të Bagazhit tuaj dhe të anulojmë rezervimin (rezervimet) tuaj.

13.3.5 Në aspektet e tjera, për të gjitha veprat që kryhen në bord, do të zbatohen dispozitat e “Konventës së Tokios mbi shkeljet dhe veprat e tjera të kryera në bordin e Avionëve”, të nënshkruar më 14 shtator 1963 dhe të njoftuar përmes “Rregullit statutor të vitit 1971, Nr. 24”, dhe çdo ligj tjetër drejtues.

13.3.6 Duhanpirja e çdo lloji, duke përfshirë cigaret elektronike, është e ndaluar në bordin e avionëve tanë. Çdo përpjekje për duhanpirje mund të rezultojë në ngritjen e padive të rrepta penale kundër jush dhe ne do t'ju paditim për dëmet e shkaktuara. Gjithashtu, në këto raste ne rezervojmë të drejtën të

refuzojmë transportin e mëtejshëm tuajin ose të Bagazhit tuaj dhe t'ju anulojmë rezervimin (rezervimet).

13.4 Katering dhe Shërbimet e tjera

13.4.1 Ne mund të ofrojmë pije dhe ushqime të lehta për shitje në fluturimet tona.

13.4.2 Në rastin e një transporti të kryer nga shumë operatorë fluturimi, ne jemi përgjegjës (në përputhje me këto Kushte të përgjithshme të transportit) vetëm për segmentin e transportit që kryejmë.

14. BAGAZHI

14.1 Llojet e Bagazhit, Bagazhi i lejuar

14.1.1. Për arsye shëndeti dhe sigurie, pesha e një cope Bagazhi të regjistruar nuk duhet të kalojë 32 kilogramë për copë. Dimensionet maksimale të një cope Bagazhi të regjistruar janë: 149,9 x 119,4 x 171,5 cm. Ne rezervojmë të drejtën të kufizojmë numrin e artikujve të Bagazhit të regjistruar për pasagjer. Nëse ka në fuqi kufizime të tilla, ato disponohen në Uebsajt ose nga Call Center-i ynë. Ne do të refuzojmë transportin e Bagazhit të regjistruar mbi çdo limit të tillë siç përcaktohet këtu në Nenin 14.1.

14.1.2. NE DO TË FATUROJMË NJË TARIFË TRAJTIMI PËR ÇDO COPË BAGAZHI TË REGJISTRUAR. SHUMA E KËTYRE TARIFAVE DISPONOHET NË FAQEN E INTERNETIT OSE NGA QENDRA JONË TELEFONIKE. NËSE PESHA TOTALE E BAGAZHIT TUAJ TË REGJISTRUAR TEJKALON LEJIMIN PËR BAGAZH TË REGJISTRUAR QË KENI ZGJEDHUR, NE DO TË TARIFUJMË NJË TARIFË PËR BAGAZHET MBI PESHËN E LEJUAR PËR ÇDO KILOGRAM TË TEPËRT SIPAS ÇMIMIT NË FUQI NË DITËN E UDHËTIMIT. SHUMA E KËTYRE TARIFAVE DISPONOHET NË FAQEN E INTERNETIT OSE NGA QENDRA JONË TELEFONIKE. NE DO TË REFUZOJMË TRANSPORTIN E BAGAZHIT TË REGJISTRUAR NËSE NUK ËSHTË PAGUAR TARIFA E DUHUR E PËRPUNIMIT DHE/OSE E PESHËS SË TEPËRT.

14.1.3. JU MUND TË TRANSPORTONI VETËM NJË COPË BAGAZHI DORE PËR PASAGJER, QË DUHET TË RESPEKTOJË KUFIZIMET E MËPOSHTME TË MADHËSISË: MADHËSIA E BAGAZHIT TË DORËS NUK DUHET TË TEJKALUJË 40X30X20 CM (DUKE PËRJASHTUAR DOREZAT DHE RROTAT (POR MAKS. 5 CM EKSTRA PËR RROTAT)). Përmasat e përcaktuara në këtë artikull 14.1.3 përfshijnë xhepat anësorë.

14.1.4. Disa shërbime opsionale të Wizz Air ju lejojnë të mbani bagazhe ekstra në bord që nuk tejkalojnë përmasat 55x40x23 cm dhe peshën 10 kg (duke përjashtuar dorezat dhe rrotat, por maks. 5 cm ekstra për rrotat) përveç bagazhit të dorës. .

14.1.5. NËSE MADHËSIA DHE/OSE PESHA E BAGAZHIT TUAJ TË PAREGJISTRUAR TEJKALON KUFIZIMET E MËSIPËRME, TRANSPORTI I BAGAZHEVE TË TILLA TË PAREGJISTRUARA MBIMADHËSI/MBIPESHË I NËNSHTROHET PAGESËS SË NJË TARIFE TEJKALIMI (TARIFA PËR MBIMADHËSI/MBIPESHË) TË PËRCAKTUAR NË FAQEN TONË NË INTERNET. NE RUAJMË TË DREJTËN T'I TRANSPORTOJMË BAGAZHET E PAREGJISTRUARA MBIMADHËSI/MBIPESHË SI BAGAZHE TË REGJISTRUARA. Për shkak të hapësirës së kufizuar madhësia maksimale e çdo bagazhi të paregjistruar që merret në kabinë nuk mund të tejkalojë përmasat 55x40x23 cm dhe peshën 10 kg (duke përjashtuar dorezat dhe rrotat, por maks. 5 cm ekstra për rrotat). Në rast se është e nevojshme për shkaqe pune dhe/ose sigurie ne ruajmë të drejtën të transportojmë çdo bagazh të paregjistruar që respekton kufizimet e mësipërme për madhësinë dhe peshën, pa pagesë në seksionin e mallrave. Kjo dispozitë nuk zbatohet për artikujt personale sipas 14.1.6.

14.1.6. Përveç bagazhit të paregjistruar mund të merrni në bord pa paguar tarifë të veçantë artikujt e mëposhtëm të vegjël personalë:

- a. xhaketë ose batanije;
- b. telefon celular;
- c. materiale leximi për fluturimin;
- d. për fëmijët nën moshën dyvjeçare: ushqim për fluturimin;
- e. artikuj pa doganë të blerë në lounge-in e nisjes, pasi keni kaluar përmes kontrollit të sigurisë;

- f. një palë paterica për personat me aftësi të kufizuara fizike;
 - g. ndenjëse makine me pamje prapa për foshnja, e pajisur me rrip ndenjëseje, nëse Foshnja udhëton në një ndenjëse të paguar veçmas në avion, dhe ndenjësja e makinës është e pajisur me një kapëse që mundëson lidhjen e saj të sigurt me rripin e ndenjësës së pasagjerit.
- 14.1.7. Disa aeroporte mund të kenë kufizime të mëtejshme përmes politikave në lidhje me bagazhet e peregjistruara dhe artikujt personalë dhe të cilat mund të jenë më kufizuese sesa më lart. Në këto raste mbizotërojnë rregulloret e aeroportit.
- 14.1.8. Në aeroporte të caktuara, tarifa përkatëse mund të paguhet vetëm duke përdorur kartë krediti ose debiti. Për listën e këtyre aeroporteve, ju duhet të konsultoheni me Uebsajtin tonë ose telefononi Call Center-in tonë. Nëse do t'ju njoftojmë për listën e përditësuar të këtyre aeroporteve në Uebsajt. Nëse ne nuk e përditësojmë listën e këtyre aeroporteve në Uebsajt, ne jemi përgjegjës për çdo dëm që lind në mënyrë direkt nga kjo siç përcaktohet në këto Kushte të përgjithshme transporti dhe në ligjet përkatëse.
- 14.1.9. **NËSE JU NUK PAGUANI TARIFËN E APLIKUESHME PËR BAGAZHIN E REGJISTRUAR, NE MUND TA REFUZOJMË TRANSPORTIN E BAGAZHIT TUAJ. PËRMES KËSAJ NE PËRJASHTOJMË ÇDO PËRGJEGJËSI PËR DËME QË LINDIN NGA KY REFUZIM.**
- 14.1.10. Bagazhin tuaj të peregjistruar dhe artikujt e tjerë të marrë në bord duhet t'i ruani në mënyrë të tillë që korridoret e kalimit dhe daljet e emergjencës të jenë të lira, në pajtim me udhëzimet e ekuipazhit.
- 14.1.11. Për karrocën e fëmijëve dhe karrocën e invalidëve duhet të bëhet checkin si me çdo Bagazh tjetër dhe do të transportohen falas, nëse është duke udhëtuar edhe përdoruesi i pajisjes.

14.2 Pranimi i Bagazhit

- 14.2.1. Kur e pranojmë Bagazhin tuaj për transport si Bagazh të regjistruar, ne do të lëshojmë një Etiketë identifikuese Bagazhi dhe një Etiketë kërkuese Bagazhi për secilën copë Bagazhi të regjistruar.
- 14.2.2. Bagazhi juaj i regjistruar do të transportohet në të njëjtin avion me ju.

14.3 Artikujt e përjashtuar nga transporti

- 14.3.1. **ARTIKUJT E MËPOSHTËM PËRJASHTOHEN NGA TRANSPORTI (KËTO NUK DUHET TË VENDOSEN ME BAGAZHIN TUAJ TË REGJISTRUAR APO TË PAREGJISTRUAR, AS T'I MERRNI ME VETE SI ARTIKUJ PERSONALË):**
- a. armët dhe eksplozivët duke përfshirë armët e gjuetisë për qëllime sportive siç përcaktohet nga ligji i ndonjë prej Vendeve të prekura nga Transporti të listuara në Itinerar;
 - b. çdo artikull apo substancë që duket si armë apo eksploziv;
 - c. substancat e ndezshme (përveç: pijeve alkoolike, spërkatësve për flokët, parfumit, kolonjës); d. materialet radioaktive;
 - e. gazi i kondensuar (përveç: gazit CO₂ që përdoret për lëvizjen e gjymtyrëve artificiale; kontejnerët e gazit të ndezshëm që përdoret për jelekët e shpëtimit me fryrje automatike);
 - f. substancat helmuese ose infektive;
 - g. substancat gërryese (përveç: merkurit në termometra, barometra, në baterinë e karrocave të invalidëve);
 - h. valixhet e sigurisë, çantat ose valixhet e biznesit me pajisje alarmi të integruara që përmbajnë bateri me litium ose materiale piroteknike;
 - i. artikujt dhe materialet që rrezikojnë sigurinë e avionit ose të jetës, shëndetit, integritetit trupor ose pronës së personave në bord;
 - j. çdo artikull ose material që është i ndaluar sipas rregullave dhe rregulloreve të Vendeve të prekura nga Transporti;
 - k. çdo artikull që nuk është i përshtatshëm për transport për shkak të peshës, madhësisë ose karakteristikave të tjera; l. eshtrat e trupave njerëzore;
 - m. çdo artikull i specifikuar në “Udhëzimet teknike për transportin e sigurt të mallrave të rrezikshme me rrugë ajrore” të International Civil Aviation Organization (ICAO) dhe “Rregulloret për mallrat e rrezikshme” të International Air Transport Association (IATA) me disa kufizime të mëtejshme. Për detaje rreth kufizimeve, ju lutemi vizitoni Uebsajtin tonë.

NËSE PËRPIQENI TË MERRNI ME VETE NDONJË PREJ KËTYRE MATERIALEVE, NE MUND TË REFUZOJMË TRANSPORTIN E BAGAZHIT TUAJ DHE/OSE TRANSPORTIN TUAJ.

14.3.2. NËSE BAGAZHI I REGJISTRUAR PËRMBAN NDONJË PREJ ARTIKUJVE TË

MËPOSHTËM: a. të holla, letra me vlerë;

b. bizhuteri, metale të çmuara, gurë të çmuar dhe gjysmë të çmuar;

c. kompjuter, kamerë, videokamerë, telefon celular dhe çdo pajisje tjetër elektronike ose teknike dhe aksesorët e tyre;

d. dokumente zyrtare, biznesi ose private;

e. dokumente udhëtimi ose dokumente të tjera identiteti;

f. çelësa;

g. lëngje;

h. ilaçe;

i. artikuj delikatë.

j. vepra arti dhe artizanati;

k. artikuj të listuar në paragrafin 14.3.1.

NE NUK DO TË JEMI PËRGJEGJËS PËR VONESËN, HUMBJEN OSE DËMTIMIN E KËTYRE ARTIKUJVE.

Disa aeroporte mund të kenë kufizime të mëtejshme përmes politikave. Në këto raste mbizotërojnë rregulloret e aeroportit.

14.3.3. Bagazhi juaj i paregjistruar ose artikulli juaj personal nuk duhet të përmbajë armë të vjetra, shpata, thikë, gërshërë, takëme, shigjeta, shiringa dhe sende të tjera të mprehta dhe çdo artikull që sipas mendimit tonë mund të përdoret si armë.

14.3.4. Bagazhi juaj i paregjistruar ose artikulli juaj personal mund të përmbajë vetëm artikuj që nuk përjashtohen nga transporti dhe vetëm në sasinë dhe paketimin e përcaktuar herë pas here nga ligjet në fuqi dhe rregulloret e sigurisë.

14.4 Artikujt me transport të kushtëzuar

14.4.1. Nëse dëshironi të transportoni ndonjë prej artikujve të mëposhtëm, ju kërkohet të na informoni rreth qëllimit tuaj në momentin e rezervimit:

a. artikuj të brishtë,

b. lëndë të një natyre të pakëndshme;

c. karrocë invalidi me bateri me xhel (që nuk derdhet) dhe vetëm si Bagazh të regjistruar;

d. artikuj të tjerë specialë duke përfshirë, por pa u kufizuar me, pajisje për ski, snoubord, golf, zhytje dhe sërf, pajisje peshkimi, brirë dhe trofe, biçikleta, shkopinj për hedhje së gjati, instrumente muzikore etj.

Juve ju kërkohet të na njoftoni përmes Call Center-it tonë rreth qëllimit tuaj për të transportuar ndonjë prej artikujve të mësipërm. Ju keni të drejtën t'i transportoni këta artikuj vetëm me miratimin tonë.

14.4.2. Nëse dëshironi të transportoni me vete ndonjë artikull të përmendur në Nenin 14.4.1 a), b) dhe d), do t'ju kërkohet të paguani një tarifë sipas Tarifave tona. Për detaje duhet të konsultoheni me Uebsajtin tonë ose telefononi Call Center-in tonë.

14.4.3. Nëse nuk raportoni e merrni pëlqimin tonë për transportimin e artikujve të përmendur në nenin 14.4.1 ne mund t'ju refuzojmë transportin dhe/ose nuk do të jemi përgjegjës për humbjen, shkatërrimin, vonesën dhe dëmtimin e këtyre artikujve.

14.4.4. Ne nuk jemi përgjegjës për dëmet tek artikujt e brishtë si rezultat i transportit. Bagazhet që përmbajnë artikuj të brishtë mund të transportohen si Bagazh i regjistruar vetëm me Etiketën e lëshimit të kufizuar.

14.4.5. Juve do t'ju kërkohet të paguani një tarifë për transportin e çdo pajisjeje sportive, instrumenti muzikor dhe artikujve të tjerë të caktuar, që ne biem dakord të transportojmë, duke iu nënshtruar kushteve dhe kufizimeve tona.

14.5 Kafshët

- 14.5.1. Ne nuk transportojmë kafshë të gjalla në fluturimet tona përveç qenve asistues të pranuar (ose qenve asistues siç specifikohet në “Dekretin hungarez SZMM 27/2009”) në itinerare të caktuara në përputhje me “Rregulloren 1107/2006/EC”.
- 14.5.2. Nëse keni nevojë të udhëtoni me qen asistues të njohur, është përgjegjësia juaj të zotëroni dokumentet e përcaktuara në rregulloret e Vendeve të prekura nga Transporti dhe të respektoni kushtet e këtyre rregulloreve me kusht që ju të na keni njoftuar rreth qëllimit tuaj të transportit në përputhje me paragrafin 6.2.1. Ne i transportojmë falas qentë asistues të pranuar. Për më shumë informacion, vizitoni Uebsajtin tonë.

14.6 E drejta për të refuzuar transportin e Bagazhit tuaj

- 14.6.1. Përveç Nenit 14.1, ne do të refuzojmë transportin e artikujve të përjashtuar nga transporti në përputhje me këto Kushte të përgjithshme transporti dhe artikujt me transport të kushtëzuar, transportimi i të cilëve nuk na është raportuar ose nuk është pranuar prej nesh paraprakisht në përputhje me Nenin 6.2.5.
- 14.6.2. Ne mund të refuzojmë transportin e çdo artikulli apo materiali të konsideruar nga ne si i papërshtatshëm për transport për shkak të madhësisë, formës, peshës, përmbajtjes, vetive, paketimit, ose për arsye sigurie, ose të prishjes së komoditetit të pasagjerët e tjerë.

14.7 E drejta për të kontrolluar Bagazhin

- 14.7.1. Për arsye sigurie, ne mund të kërkojmë që ju të na lejoni kontrollin e rrobave ose të Bagazhit tuaj. Nëse nuk jeni i pranishëm ose ndryshe nuk jeni i disponueshëm, Bagazhi juaj mund të kontrollohet në mungesën tuaj me qëllim përcaktimin nëse Bagazhi përmban artikuj ose materiale të përcaktuara në Nenin 14.3 ose 14.4. Nëse nuk jeni i gatshëm të respektoni këtë kërkesë, ne mund të refuzojmë t’ju transportojmë juve dhe/ose Bagazhin tuaj. Nëse gjatë kontrollit shkaktohen dëmtime të Bagazhit tuaj, ne nuk do të jemi përgjegjës për këtë dëmtim, deri në shkallën e lejuar nga dispozitat përkatëse ligjore. **14.8 Dorëzimi dhe marrja e Bagazhit të regjistruar**

Dekreti 18.§ dhe 19.§

- 14.8.1. Bagazhi dorëzohet nëpër aeroporte përmes terminaleve të dorëzimit të bagazheve dhe jo personalisht. Është përgjegjësia juaj të merrni Bagazhin tuaj te këto terminale. Ne nuk jemi përgjegjës për Bagazhin tuaj pas dorëzimit të tij. Ne mund të kontrollojmë në çdo moment Etiketat tuaja identifikuese të Bagazhit dhe Etiketat kërkuese të Bagazhit. Bagazhet e pakërkua që janë në ruajtjen tonë do t’i dorëzohen vetëm një personi që paraqet një Etiketë kërkuese Bagazhi që përputhet me Etiketën identifikuese të Bagazhit.
- 14.8.2. Sipas Nenit 14.2. Ju duhet të tërhiqni Bagazhin tuaj të regjistruar menjëherë pas vënies së tij në dispozicionin tuaj. Nëse nuk e merrni Bagazhin tuaj ose Pronën tuaj personale, ne do ta magazinonim atë për 60 ditë dhe do t’ju tarifojmë një tarifë magazinimi. Pas asaj periudhe kohore, ne do ta shesim ose do ta shkatërrojmë Bagazhin dhe Pronën tuaj personale. Nëse mund t’ju identifikojmë juve në bazë të Bagazhit ose të Pronës suaj personale, ne do t’ju njoftojmë në të dhënat e kontaktit që keni dhënë rreth qëllimit për të eliminuar artikujt e pamarrë dhe se kur ka ndodhur ky eliminim, dhe ne nuk do të kemi asnjë përgjegjësi të mëtejshme ndaj jush për dëmet e shkaktuara.

15. NDRYSHIMI I KONTRATËS NGA WIZZ AIR

15.1. Ndryshimi i kontratës nga Wizz Air

- 15.1.1. Përpara se të pranojmë rezervimin tuaj, ne do t’ju njoftojmë rreth orarit të programuar të fluturimit në fuqi në atë moment, dhe ai do të tregohet edhe në Itinerarin tuaj. Mund të ndodhë që të na nevojitet të ndryshojmë orarin e programuar të fluturimit, datën ose itinerarin (duke përfshirë Vendin e nisjes ose Vendin e destinacionit) pas lëshimit të Itinerarit tuaj. Ne do t’ju kontaktojmë për t’ju njoftuar për këtë ndryshim përmes emailit ose me telefon, në adresën e emailit ose në numrin e telefonit të dhënë në momentin e rezervimit tuaj. Në rastin e ndryshimit të orarit, datës ose të itinerarit të fluturimit, nëse i pranoni ndryshimet në çdo formë, Kontrata mes jush dhe nesh do të konsiderohet e ndryshuar përkatësisht.

Nëse nuk jeni zotëruesi i adresës së emailit ose i numrit të telefonit të regjistruar në rezervimin tuaj, është përgjegjësia juaj të pyesni zotëruesin e adresës së emailit ose përdoruesin e rregullt të numrit të telefonit të dhënë në rezervimin tuaj, rreth njoftimeve të ndryshimit.

15.1.2. Përveçse kur përcaktohet ndryshe nga Konventa ose nga Rregullorja 261, nëse pasi kryeni rezervimin, por përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit tuaj, ne e anulojmë fluturimin ose e ndryshojmë tepër orarin e programuar të nisjes dhe ndryshimi ose fluturimi i ri i ofruar është i papranueshëm për ju, dhe ne nuk jemi në gjendje t'ju rezervojmë në një fluturim tjetër që është i pranueshëm për ju, pasi të kontaktoni Call Center-in tonë, mund të zgjidhni mes opsioneve të mëposhtme:

- a) Ne ju ri-rezervojmë në një fluturim tjetër të operuar nga ne në të njëjtin itinerar ose, nëse është e nevojshme, në një itinerar të ngjashëm, brenda 14 ditëve para ose 30 ditëve pas datës së programuar të nisjes së fluturimit të vonuar/anuluar, sipas disponueshmërisë së ndenjësive; ose
- b) Ju mund ta anuloni rezervimin tuaj dhe të kërkonti rimbursim në kredi në "llogarinë tuaj të klientit" për fluturimin e anuluar dhe për segmentin e kthimit, nëse është e zbatueshme; ose
- c) Ju mund ta anuloni rezervimin tuaj dhe të kërkonti rimbursim të Tarifës totale të fluturimit të paguar për fluturimin e anuluar dhe, nëse është e zbatueshme, segmentin e kthimit (duke përfshirë taksat dhe tarifën).

Nëse dëshironi të ndryshoni zgjedhjen tuaj, mund ta bëni këtë sipas rregullave të përgjithshme dhe duke paguar tarifën përkatëse.

Ju lutemi vini re se në lidhje me Shërbimet shtesë në rast anulimi, do të zbatohen politika e anulimit dhe e rimbursimit të ofruesit palë e tretë.

15.2. Fluturimet tranzit

15.2.1. Ne nuk operojmë Fluturime tranziti. Ju mbartni mbi vete rrezikun e humbjes së ndonjë fluturimi tjetër prej jush ose bagazhit tuaj.

15.3. Transporti alternativ

15.3.1. Ne mund t'ju transportojmë me mjete alternative transporti ndryshe nga transporti ajror në rast ndryshimi të itinerarit ose ri-rezervimi.

15.3.2. Nëse keni rënë dakord për një transport alternativ në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar, Kontrata do të konsiderohet e përmbushur nga kryerja e transportit alternativ, dhe ne nuk kemi asnjë përgjegjësi të mëtejshme ndaj jush. Ju nuk do të keni të drejtën për rimbursim të Tarifës totale të fluturimit ose të një pjese të saj dhe/ose ndonjë kompensim.

15.4. Devijimet

15.4.1. Nëse nuk jemi në gjendje të nisemi nga Vendi i nisjes ose të ulemi në Vendin e destinacionit ose në Vendin e ndalimit të rënë dakord dhe avioni devijohet në një aeroport tjetër (i referuar këtu si "devijim"), përveçse kur avioni vazhdon drejt Vëndit të destinacionit, ne do të përgatisim transport për ju drejt Vëndit të destinacionit qoftë me shërbimet tona ose përmes ndonjë mjeti tjetër transporti. Në raste të tilla Kontrata do të konsiderohet e përmbushur, dhe ne nuk kemi përgjegjësi të mëtejshme ndaj jush.

15.5. Zbatimi i të drejtave tuaja

15.5.1. Nëse ne nuk e zbatojmë këtë Nen, ju keni të drejtën të paraqisni një kërkesë pranë Autoritetit Kombëtar të Mbrojtjes së Konsumatorit ose inspektorateve të tij rajonale.

15.6. E drejta për informacion

15.6.1. Në rastin kur ju refuzojmë imbarkimin ose ju anulojmë fluturimin, ne do t'ju japim juve (në aeroport) informacion me shkrim ku përcaktohen rregullat për kompensim dhe asistencë. Nëse prekeni nga një vonesë prej të paktën dy orësh ne do t'ju japim gjithashtu informacion të ngjashëm. Do t'ju vihen gjithashtu në dispozicion të dhënat e kontaktit të autoritetit kombëtar përkatës të referuar në Rregulloren 261.

15.7. Rrethanat e jashtëzakonshme, Forca madhore

15.7.1. Përveçse siç jepet ndryshe në paragrafët e mëparshëm të Nenit 15, ne nuk kemi përgjegjësi të mëtejshme për asnjë ndryshim të Kontratës për shkak të Rrethanave të jashtëzakonshme ose Forcës madhore. Deri në masën e lejuar nga ligjet përkatëse dhe këto Kushte të përgjithshme transporti, ne refuzojmë përgjegjësinë për çdo dëm ose humbje të shkaktuar nga Rrethanat e jashtëzakonshme ose Forca madhore.

15.8. Zbatueshmëria

15.8.1. Nenet 15.1.2, 15.6 të këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit nuk aplikohen nëse udhëtoni pa pagesë ose me një tarifë fluturimi që është reduktuar dhe nuk është e disponueshme drejtpërdrejt ose tërthorazi për publikun.

16. RIMBURSIMI DHE E DREJTA PËR PËRKUJDESJE

16.1. Rimbursimi

16.1.1 Përveçse siç jepet qartësisht në këto Kushte të përgjithshme transporti, të gjitha Tarifatat tona të transportit, taksat dhe Tarifatat për Shërbimet e tjera janë të parimbursueshme.

16.1.2 Pa paragjykim ndaj nenit 16.1.1 më lart, mund të disponohet një kategori e rimbursueshme tarife fluturimi për blerjet për transportin ajror drejt/nga destinacione të caktuara. Këto tarifa fluturimi, nëse disponohen, nuk mund të rezervohen përmes Ueb-sajtit, por mund të blihen vetëm përmes Call Center-it.

16.1.3 Nëse keni të drejtën për ndonjë rimbursim sipas këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit, ose Rregullores 261 ose ndryshe, dhe nëse nuk udhëzohemi ndryshe prej jush, ne do t'ju paguajmë rimbursimin vetëm juve. Një rimbursim që i bëhet dikujt tjetër që prezantohet si Rezervuesi, përmes përdorimit të rezervimit përkatës (duke përfshirë kodin e rezervimit) ose çdo dokumentacion tjetër të dhënë prej nesh në lidhje me të cilin ne nuk kemi asnjë arsye të besojmë se nuk është Rezervuesi, do të konsiderohet si rimbursim i vërtetë dhe do të na shkarkojë nga përgjegjësia dhe çdo pretendim i mëtejshëm për rimbursim nga Rezervuesi ose ndonjë Pasagjer.

16.1.4 Në përgjithësi rimbursimi do të paguhet në monedhën në të cilën është paguar për transportin. Nëse është e pamundur, ne do ta bëjmë pagesën në Euro.

16.2. E drejta për përkujdesje

16.2.1. Nëse keni të drejtën për përkujdesje sipas Rregullores 261, ne do t'ju ofrojmë falas:

- a) ushqime dhe pije freskuese në përpjesëtim të arsyeshëm me kohën e pritjes gjatë periudhës së vonesës;
- b) përgatitjen e akomodimit në hotel ose rimbursimin e kostove të akomodimit në hotel në rastet
 - ku bëhet i nevojshëm qëndrimi për një ose më shumë net, ose
 - ku bëhet i nevojshëm qëndrimi në Vendin e nisjes më shumë se ai i synuar prej jush;
- c) përgatitjen e transportit ose rimbursimin e kostove të transportit mes aeroportit dhe vendit të akomodimit të specifikuar në Nenin 16.2.1 b) (hotel apo tjetër).

Ju do të keni të drejtën vetëm të kërkoni përkujdesjen sipas Nenit 16.2.1 a) gjatë periudhës së pritjes të shkaktuar nga vonesa.

Ne do t'ju rimbursojmë kostot për asistencën të specifikuar në Nenet 16.2.1 b) dhe c) për një shumë të arsyeshme, të mbështetur me faturë (fatura).

16.2.2. Gjithashtu, ne do t'ju ofrojmë dy telefonata, mesazhe me teleks ose faks, ose emaile ose rimbursimin e kostove të verifikuara për këto komunikime.

16.2.3. Ne nuk do t'ju japim shërbimin e specifikuar në Nenin 16.2.1 nëse ai do të shkaktonte vonesa të mëtejshme të fluturimit.

17. PËRGJEGJËSIA

17.1. Të përgjithshme

17.1.1. Përgjegjësia jonë përcaktohet nga këto Kushte të përgjithshme të transportit.

- 17.1.2. NËSE ËSHTË APLIKUESHME, PËRGJEGJËSIA E WIZZ AIR PËR ÇDO DËM DO TË KUFIZOHET SIÇ PËRCAKTOHET NË KONVENTË DHE NË KËTO KUSHTE TË PËRGJITHSHME TRANSPORTI. NE JEMI PËRGJEGJËS PËR DËMET E VËRTETUARA MJAFTUESHËM DHE PËRGJEGJËSIA JONË NUK DO TË TEJKALOJË SHUMËN E DËMEVE TË VËRTETUARA.
- 17.1.3. Nëse vërtetojmë se dëmi është shkaktuar ose ndihmuar nga neglizhenca ose veprime ose mosveprime të tjera keqdashëse të personit që kërkon kompensimin, ose personi nga i cili ai ose ajo i merr të drejtat e tij ose të saj, ne do të shkarkohemi plotësisht ose pjesërisht nga përgjegjësia për të ndaj pretenduesit deri në masën që kjo neglizhencë ose veprim ose mosveprim keqdashës ka shkaktuar ose ka kontribuar në këtë dëm. Kur për shkak të vdekjes ose lëndimit tuaj kërkohet kompensim nga një person ndryshe nga Pasagjeri, ne do të shkarkohemi pjesërisht ose plotësisht nga përgjegjësia për të deri në masën që vërteton se dëmi është shkaktuar ose ndihmuar nga neglizhenca juaj ose veprimi ose mosveprimi juaj keqdashës. Kjo dispozitë aplikohet për të gjitha dispozitat e përgjegjësive të aplikueshme për ne kundrejt jush.
- 17.1.4. Sipas sa më lart, ne nuk jemi përgjegjës për asnjë dëm që shkaktohet prej jush ose prej Bagazhit tuaj. Ju do të jeni përgjegjës për këto dëme që iu shkaktohen personave të tjerë ose pronës së personave të tjerë (duke përfshirë pronën tonë).
- 17.1.5. Kontrata e transportit, këto Kushte të përgjithshme transporti dhe përjashtimet e kufizimet e përgjegjësive aplikohen për punonjësit, punëtorët e shërbimit dhe agjentët tanë deri në të njëjtën masë që na aplikohen neve. Shuma totale e rikuperueshme prej nesh dhe nga këta persona nuk do të tejkalojë limitin e sipërm të përgjegjësive sonë, të përcaktuar në këto Kushte të përgjithshme të transportit.
- 17.1.6. PËRVEÇSE KUR JEPET NDRYSHE NGA KONVENTA OSE ÇDO DISPOZITË DETYRUESE E NDOJË LIGJI TË ZBATUESHËM, NE NUK JEMI PËRGJEGJËS PËR HUMBEN E FITIMEVE DHE PËR DËMET E TËRTHORTA OSE RRJEDHIMORE.

17.2. Përgjegjësia për Bagazhin

- 17.2.1. Ne jemi përgjegjës për dëmet e shkaktuara në rast dëmtimi ose shkatërrimi, humbjeje ose vonese të Bagazhit të regjistruar vetëm me kusht që ngjarja që shkaktoi dëmin, shkatërrimin, humbjen ose vonesën të ketë ndodhur në bordin e avionit ose gjatë çdo periudhe brenda së cilës Bagazhi i regjistruar ishte nën ruajtjen e Wizz Air.
- 17.2.2. Ne jemi përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga vonesa në transportin ajror të Bagazheve, përveçse kur ne, punonjësit, punëtorët e shërbimit ose agjentët tanë morën të gjitha masat që mund të kërkoreshin logjikisht për të shmangur dëmtimin ose nëse ne vërtetojmë se ishte e pamundur për ne ose ata që t'i merrnim ato masa.
- 17.2.3. Ne nuk do të jemi përgjegjës për dëmin deri në masën që dëmi ka rezultuar nga defekti, cilësia ose devijimi të mbartura të Bagazhit. Në rastin e Bagazhit të paregjistruar, duke përfshirë artikujt personalë, ne do të jemi përgjegjës vetëm nëse dëmi ka rezultuar nga faj që mund të na atribuohet neve ose punonjësve ose punëtorëve tanë të shërbimit.
- 17.2.4. Ne nuk jemi përgjegjës për dëmet, humbjen, shkatërrimin dhe vonesën e ndonjë artikulli të përjashtuar nga transporti dhe të ndonjë Bagazhi të pranuar për transport me Etiketën e lëshimit të kufizuar dhe të artikujve me transport të kufizuar, transporti i të cilëve nuk na është raportuar gjatë rezervimit ose nuk është pranuar prej nesh për transport.
- 17.2.5. Ne nuk mbajmë përgjegjësi për dëmtime të vogla në pjesën e jashtme të Bagazhit tuaj (si p.sh. gërvishtjet, ndotjet, njollat, ciflosjet etj.) që mund të rezultojnë nga konsumimi normal.
- 17.2.6. Për dëmtimin e Bagazhit (duke përfshirë Bagazhin e regjistruar, Bagazhin e paregjistruar dhe Pronën personale), përgjegjësia jonë kufizohet në 1131 SDR për çdo Pasagjerë përveçse kur Pasagjeri ka bërë, në momentin kur Bagazhi i regjistruar na është lënë neve në dorëzim, një deklaratë speciale interesi për dorëzim në destinacion dhe ka paguar një shumë suplementare në rast se këtë e kërkon rasti. Në atë rast, ne do të jemi përgjegjës për të paguar një shumë që nuk e tejkalon shumën e deklaruar, përveçse nëse arrijmë të provojmë se shumta është më e madhe se interesi aktual i Pasagjerit në dorëzimin në destinacion.

17.2.7. Ju jeni përgjegjës për t'u siguruar që nuk lini artikuj në bord pas zbritjes nga avioni. Nëse keni lënë ndonjë artikull në bord, ju këshillojmë të kontaktoni me departamentin e bagazheve të humbura në aeroport.

17.3. Përgjegjësia për vdekjen, plagosjen dhe vonesën e Pasagjerit si rezultat i një aksidenti

17.3.1. Në rastin e një aksidenti, përgjegjësia jonë për vdekjen ose plagosjen e Pasagjerëve u nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme transporti. Ne kemi përgjegjësi strikte deri në 113 100 SDR, përveç rasteve të përcaktuara në Nenin 17.1.3.

17.3.2. Për pretendimet që tejkalojnë këtë limit në rast vdekjeje ose plagosjeje të Pasagjerëve, ne mund të shkarkohemi nga përgjegjësia nëse arrijmë të vërtetojmë se (i) ky dëm nuk ka ardhur si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve tona të paligjshme, të kryera me dashje apo nga pakujdesia e punonjësve ose punëtorëve tanë të shërbimit ose se (ii) ky dëm ndodhi vetëm për shkak të veprimit ose mosveprimit keqdashës me dashje ose neglizhencës së një pale të tretë.

17.3.3. Jo më vonë se 15 ditë pasi është përcaktuar identiteti i individit që i takon kompensimi, ne do të bëjmë parapagesa të tilla për qëllime asistence siç mund të kërkohej për të plotësuar nevojat e menjëhershme ekonomike proporcionalisht me vështirësinë materiale të pësuar. Kjo pagesë nuk do të jetë më pak se 16 000 SDR për çdo Pasagjer në rastin e vdekjes. Bërja e një parapagese nuk përbën njohje të përgjegjësisë dhe mund të rakordohet kundrejt çdo ujdje të mëvonshme.

17.3.4. Parapagesat janë të parimbursueshme përveçse kur ne vërtetojmë më vonë se:

- a) dëmi është shkaktuar ose ndihmuar nga faji i Pasagjerit të plagosur ose të vdekur;
- b) personi që ka marrë parapagesën nuk kishte të drejtën për kompensim ose dëmi ishte shkaktuar nga ai person.

17.3.5. Në rastin e dëmit të shkaktuar nga vonesa në transportin e Pasagjerëve, përgjegjësia jonë për çdo Pasagjer është e kufizuar me 4694 SDR.

17.4. Pretendimet për kompensim sipas Rregullores 261

17.4.1. Pavarësisht nëse parashikohet ndryshe në këto Kushte të përgjithshme të transportit, ky nen do të zbatohet për procesin tonë të trajtimit të pretendimeve, në lidhje me kompensimin sipas Rregullores 261.

17.4.2. Një pasagjer mund të paraqesë pranë nesh një pretendim për kompensim sipas Rregullores 261 për llogarinë tuaj vetëm nëse ju dhe pasagjeri jeni në të njëjtin rezervim në lidhje me të cilin ju keni pretendim për kompensim. Ne mund të kërkojmë prova të përshtatshme se pasagjeri tjetër është i autorizuar prej jush për të paraqitur një pretendim për llogarinë tuaj.

17.4.3. **PRETENDIMI PËR KOMPENSIM SIPAS RREGULLORES 261 I DUHET DORËZUAR DREJTPËRDREJT WIZZ AIR PËRMES FAQES.** Ne do t'ju përgjigjemi drejtpërdrejt juve brenda 30 ditëve për ankesën.

17.4.4. **PËR T'JU MBROJTUR JUVE DHE TË DREJTAT TUAJA, NË RASTE KUR PASAGJERI APO REZERVUESI NUK ËSHTË PAJTUAR ME DISPOZITËN 17.4.3, WIZZ AIR DO TË PROCESOJË VETËM ANKESAT E PARAQITURA NGA NJË PALË E TRETË NËSE ANKESA PËRMBAN**

DETAJET E KONTAKTIT DHE TË PAGESËS SË PASAGJERIT, PËR T'I MUNDËSUAR WIZZ AIR KRYERJEN E PAGESËS DREJTPËRDREJT TE PASAGJERI.

17.4.5. Përveçse siç specifikohet në Nenin 17.4.2 më lart, **NE NUK DO TË PËRPUNOJMË ASNJË PRETENDIM PËR**

KOMPENSIM TË PARAQITUR NGA NJË PALË E TRETË NË RAST SE AI PRETENDIM NUK SHOQËROHET NGA DOKUMENTIMI I DUHUR DHE I PËRSHTATSHËM QË VËRTETON AUTORITETIN E PALËS SË TRETË PËR TË VEPRUAR PËR LLOGARINË TUAJ NË FORMËN E NJË DOKUMENTI PRIVAT ME FUQI TË PLOTË PROVUESE SIPAS NENIT 325. § TË KODIT TË PROCEDURËS CIVILE.

17.4.6. Për të shmangur dyshimet, asgjë këtu në Nenin 17.4 nuk synon të kufizojë të drejtën tuaj ose t'ju ndalojë juve të këshilloheni me këshillues ligjorë përpara se të paraqisni ndonjë pretendim direkt te ne.

17.4.7. **DUKE PRANUAR KËTO KUSHTE TË PËRGJITHSHME TË TRANSPORTIT, JU BINI DAKORD SHPREHIMISHT SE ÇDO PAGESË KOMPENSIMI DO TË KRYHET NË KARTËN**

E PAGESËS TË PËRDORUR PËR TË KRYER REGJISTRIMIN OSE NË LLOGARINË BANKARE TË NJË PASAGJERI NË REZERVIM. WIZZ AIR MUND TË KËRKOJË PROVA SE LLOGARIA BANKARE ZOTËROHET NGA PASAGJERI NË FJALË.

17.4.8. NËSE E CAKTONI PRETENDIMIN TUAJ, WIZZ AIR NUK DO TË KETË DETYRIM T'I KRYEJË NDONJË PAGESË PERSONIT TË CAKTUAR DHE NËSE NUK PËRMBUSHEN KUSHTET E MËPOSHTME:

A) WIZZ AIR MERR NJË NJOFTIM ME SHKRIM TË PËRCAKTIMIT QË IDENTIFIKON PRETENDIMIN E CAKTUAR (DUKE TREGUAR SË PAKU NUMRIN E REZERVIMIT, BAZËN E PRETENDIMIN DHE DATËN E AFATIT). NJOFTIMI OSE DO TË NËNSHKRUHET NGA CAKTUESI OSE AKTI I PËRCAKTIMIT (ORIGJINAL APO KOPJE E CERTIFIKUAR) DUHET TË BASHKËLIDHET; DHE

B) WIZZ AIR MERR NJË UDHËZIM TË SHKRUAR PERFORMANCE SIPAS MIRATIMIT NË NENIN 6:198 TË KODIT CIVIL. PËRVEÇ NËSE NJOFTIMI NË PËRCAKTIM ËSHTË DËRGUAR NGA CAKTUESI APO AKTI I PËRCAKTIMIT I ËSHTË OFRUAR TANIMË WIZZ AIR. UDHËZIMI I PERFORMANCËS DUHET OSE TË NËNSHKRUHET NGA CAKTUESI OSE AKTI I PËRCAKTIMIT DUHET TË BASHKËLIDHET.

PËR QËLLIMET E KËTIJ NENI 17.4.8, NJË NJOFTIM I SHKRUAR/UDHËZIM PERFORMANCE ËSHTË NJË DEKLARATË E KRYER NË FORMË DOKUMENTI PRIVAT ME FORCË TË PLOTË PROVUESE SIPAS NENIT 325. § TË KODIT TË PROCEDURËS CIVILE.

17.4.9. PËR TË MBULUAR KOSTOT E WIZZ AIR TË LIDHURA ME PËRCAKTIMIN, WIZZ AIR TARIFON NJË TARIFË PËR ADMINISTRIMIN E PËRCAKTIMIT, PËR ÇDO PRETENDIM TË PËRCAKTUAR PËR SECILIN PASAGJER, NË SHUMËN E PUBLIKUAR NË FAQE ME KALIMIN E KOHËS. CAKTUESI DHE I CAKTUARI DO TË JENË SË BASHKU DHE VEÇMAS PËRGJEGJËS PËR PAGESËN E TARIFËS SË PËRCAKTIMIT DHE SHPENZIME TË TJERA

QË BUROJNË NGA PËRCAKTIMI NË PËRPUTHJE ME NENIN 6:200 § TË KODIT CIVIL. WIZZ AIR MUND TË ZBRESË TARIFËN E CAKTIMIT NGA ÇDO SHUMË E PAGUESHME PËR JU OSE PERSONIN E CAKTUAR.

17.4.10. Një kompensim që i bëhet një pasagjeri që vepron për llogarinë tuaj do të konsiderohet pagesë e vërtetë e kompensimit dhe do të na shkarkojë neve nga përgjegjësia dhe çdo pretendim të mëtejshëm nga ju për pagesë kompensimi.

18. NJOFTIMI NË KOHË PËR ANKESAT, KUFIZIMI KOHOR PËR PADITË

18.1. Dëmtimet e Bagazhit

18.1.1. Pranimi i Bagazhit pa paraqitur ankesa dhe pa plotësuar Raportin e parregullsive në pronë (Property Irregularity Report - PIR) është provë se Bagazhi është dorëzuar në gjendje të mirë dhe në përputhje me Kontratën e transportit.

18.1.2. Nëse bagazhi juaj nuk mbërrin me fluturimin që ju transporton juve, ju duhet të bëni menjëherë një raportim dhe të plotësoni formularin PIR përpara se të dilni nga zona e transitit. Nëse nuk e plotësoni këtë kërkesë, ne do të përjashtohemi nga përgjegjësia.

18.1.3. Nëse Bagazhi juaj i regjistruar është i dëmtuar ose i vjedhur, ju duhet të bëni menjëherë një raportim dhe të plotësoni formularin PIR përpara se të dilni nga zona e tranzitit. Nëse është e pamundur të dalloni dëmin apo vjedhjen pas marrjes së Bagazhit të regjistruar, ju duhet të bëni një raportim më pas në aeroport brenda 7 ditëve nga marrja.

18.1.4. Nëse Bagazhi juaj i regjistruar nuk mbërrin me fluturimin tuaj dhe ju e merrni të dëmtuar ose të vjedhur, ju duhet të bëni një raportim mbi dëmin ose vjedhjen me shkrim brenda 21 ditëve pasi Bagazhi është vënë në dispozicionin tuaj. Nëse pranojmë humbjen e Bagazhit tuaj, ose nëse Bagazhi juaj i regjistruar nuk ka mbërritur pas skadimit të 21 ditëve pas datës në të cilën duhej të kishte mbërritur, ju keni të drejtën të zbatoni të drejtat tuaja në lidhje me të.

18.1.5. Nëse i ndodh ndonjë dëm Bagazhit tuaj të regjistruar ose Pronës suaj personale, ju duhet të bëni një raportim në bordin e avionit. Nëse nuk e plotësoni këtë kërkesë, ne do të përjashtohemi nga përgjegjësia.

- 18.1.6. Nëse i ndodh Bagazhit tuaj ndonjë dëm gjatë transportit ajror nga ne, ju do ta dërgoni Bagazhin tuaj për riparim, do të merrni faturat dhe do të na i dërgoni ato. Nëse Bagazhi juaj është dëmtuar aq sa nuk mund të riparohet, ju lutemi merrni një konfirmim me shkrim nga dyqani i riparimit, duke përfshirë deklarinimin e markës dhe të vlerës së Bagazhit tuaj.
- 18.1.7. Pretendimet duhet të na dërgohen neve me shkrim në secilin rast duke bashkëngjitur formularin PIR dhe çdo dokument që vërteton kërkesën tuaj pas mbërritjes në Vendin e destinacionit.
- 18.1.8. Nëse nuk paraqitet asnjë pretendim brenda afateve të lartpërmendura, nuk do të vendoset asnjë masë kundër nesh.

18.2. Ankesat

- 18.2.1. Ankesat në lidhje me transportin ajror (ndryshe pretendimet për bagazhet) duhet të bëhen me shkrim sa më shpejt të jetë e mundur, pas mbërritjes së fluturimit në lidhje me të cilin dëshironi të ankoheni, por jo më vonë se 2 muaj nga zbulimi i rrethanave që kanë sjellë ankesën. Ju jeni përgjegjës për çdo humbje apo dëmtim që lind nga vonesa në paraqitjen e ankesës suaj. Ne do ta vlerësojmë ankesën në përputhje me Kushtet e përgjithshme të transportit që janë në fuqi në datën e Kontratës.

18.3. Kufizimi i padive

- 18.3.1. E DREJTA JUAJ PËR TË NGRITUR NJË PRETENDIM TË ÇFARËDO NATYRE (DUKE PËRFSHIRË PRETENDIMET SIPAS RREGULLORES 261) KUNDËR NESH DO TË RRËZOHEN NËSE JU NUK NGRINI PADI BRENDA 2 VITEVE NGA DATA E MBËRRITJES NË DESTINACION, OSE NGA DATA NË TË CILËN AVIONI DUHEJ TË MBËRRINTE, OSE NGA DATA NË TË CILËN TRANSPORTI NDALOI.

19. RREGULLORJA CHARTER

Dekreti 3.§ (3)

- 19.1. Në lidhje me fluturimet charter, do të aplikohen dispozitat e këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit me ndryshimet e mëposhtme.
- 19.1.1. Aplikohen kushtet e mëposhtme për transportin charter të ofruar prej nesh:
- a) Kushtet e Kontratës dhe njoftimet e tjera të përcaktuara në Itinerarin tuaj dhe rreth të cilave ju do të njoftoheni me gojë në rast rezervimi të kryer përmes Call Center-it tonë;
 - b) këto Kushte të përgjithshme transporti;
 - c) Konventa;
 - d) Ligji drejtues;
 - e) Marrëveshja Charter.
- 19.1.2. Është përgjegjësia e agjentit tuaj të udhëtimit që përgatit fluturimin charter t'ju njoftojë rreth kushteve që aplikohen për transportin tuaj. Agjenti i udhëtimit do të jetë përgjegjës për të gjitha dëmet që shkaktohen nga mosinformimi përkatësisht nga ana e agjentit të udhëtimit.
- 19.1.3. Rezervimi juaj kryhet nga agjenti juaj i udhëtimit që do t'ju japë juve kodin e rezervimit.
- 19.1.4. Nuk lejohet ndryshimi i itinerarit. Rregullat për ndryshimin e orarit, transferimin dhe anulimin e rezervimit tuaj (edhe për shkak të vdekjes së një anëtari të afërt të familjes), përcaktohen nga agjencia juaj e udhëtimit sipas Marrëveshjes Charter të lidhur me ne.
- 19.1.5. Juve ju kërkohet të njoftoni agjencinë tuaj të udhëtimit rreth aftësive tuaja të kufizuara fizike, aftësive të kufizuara në lëvizje, sëmundjeve të rënda ose ngjitëse, si dhe çdo gjendjeje tjetër që kërkon kujdes mjekësor, në momentin e rezervimit. Në rast se shtatzënia juaj është pas javës së 28 në momentin e udhëtimit të vajtjes ose të ardhjes, kjo duhet t'i raportohet agjencisë së udhëtimit në ditën e rezervimit dhe ju duhet t'i paraqisni agjencisë së udhëtimit certifikatën tuaj mjekësore. Është përgjegjësi e agjentit tuaj të udhëtimit të na japë informacionin që ju i jepni dhe të na paraqesë certifikatën tuaj mjekësore. Nëse agjenti i udhëtimit nuk respekton kërkesat e mësipërme, agjencia e udhëtimit do të jetë përgjegjëse për dëmet e shkaktuara për shkak të refuzimit të transportit tuaj.
- 19.1.6. Nëse dëshironi të transportoni Bagazhe speciale ose artikuj me transport të kushtëzuar, ju duhet të informoni agjentin tuaj të udhëtimit. Është përgjegjësi e agjentit tuaj të udhëtimit të na paraqesë neve kërkesën tuaj (shikoni Nenin 14.4). Nëse agjenti i udhëtimit nuk respekton kërkesat e

mësipërme, agjencia e udhëtimit do të jetë përgjegjëse për dëmet e shkaktuara për shkak të mosinformimit tonë.

- 19.1.7. Neni 6.3 dhe Neni 7 i këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit nuk aplikohen për transportin charter.
- 19.1.8. Pretendimet dhe ankesat (duke përfshirë pretendimet për bagazhe dhe pretendimet që lindin për shkak të ndryshimit të orarit, vonesës, anulimit ose devijimit) duhet t'i paraqiten agjentit tuaj të udhëtimit me shkrim. Aplikohen të gjitha kufizimet e treguara në Nenin 18.
- 19.1.9. Agjencia e udhëtimit që rezervon fluturimin si charter do të mbartë të gjitha kostot që ndodhin për arsye përtej kontrollit tonë.
- 19.1.10. Çdo kosto që lind nga mbiprenotimi i fluturimeve, do të mbartet nga agjencia e udhëtimit që rezervon fluturimin si charter.
- 19.1.11. Nëse keni të drejtën për rimbursim, ne do ta paguajmë atë te agjencia juaj e udhëtimit, prandaj kërkesën tuaj duhet t'ua paraqisni atyre me shkrim.

20. ZGJIDHJA ALTERNATIVE E MOSMARRËVESHJEVE

- 20.1. Nëse nuk jeni i kënaqur me përgjigjen tonë ndaj ankesës suaj, në vende të caktuara mund t'ia referoni ankesën tuaj një organi alternativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
Në Hungari, ju mund ta paraqisni ankesën tuaj te organet pajtuese të përcaktuara nga dhomat e tregtisë dhe industrisë të vendit (<http://www.bekeltetes.hu/index.php?id=testuletek>). Në Mbretërinë e Bashkuar organi kompetent është Ombudsmani për Tregtinë me Pakicë (të dhënat e kontaktit: www.theretailombudsman.org.uk, email: aviation@theretailombudsman.org.uk, telefon: 44 (0) 203 540 8063).
Organet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ofrojnë falas për pasagjerët skema për zgjidhjen e pavarur dhe të pjesshme të mosmarrëveshjeve. Për më shumë informacion, vizitoni Uebsajtin.
- 20.2. Gjithashtu mund ta paraqisni ankesën tuaj përmes platformës së Shërbimit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në linjë të Komisionit Evropian në <http://ec.europa.eu/consumers/odr/> (ODR). Ju lutemi shikoni detajet e ODR-së në Uebsajt.

21. ZGJEDHJA E LIGJIT DHE JURIDIKSIONI

- 21.1. PËRVEÇSE KUR JEPET NDRYSHE NGA KONVENTA OSE DISPOZITAT DETYRUESE TË NDONJË LIGJI TË ZBATUESHËM:
 - a) KËTO KUSHTE TË PËRGJITHSHME TRANSPORTI DHE ÇDO TRANSPORT QË NE BIEM DAKORD T'JUA OFROJMË (NË LIDHJE ME JU DHE/OSE BAGAZHIN TUAJ) DO TË DREJTOHEN NGA LIGJET E HUNGARISË; DHE
 - b) ÇDO MOSMARRËVESHJE MES JUSH DHE NESH NË LIDHJE OSE SI REZULTAT I KËTIJ TRANSPORTI NË ÇDO MËNYRË TË MUNDSHME DO T'I NËNSHTROHET JURIDIKSIONIT JOEKSKLUZIV TË GJKATAVE NË HUNGARI. "JURIDIKSION JOEKSKLUZIV" DO TË THOTË SE JU MUND TË NGRINI NJË PRETENDIM KUNDËR NESH NË NJË JURIDIKSION JASHTË GJKATAVE TË HUNGARISË.